FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.137 19 tetor 2007

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9809 datë 27.9.2007	Për ratifikimin e Konventës nr.147 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) "Për standardet minimale për anijet tregtare, 1976", si dhe të Protokollit të vitit 1996 të Konventës "Për transportin tregtar" ……	3759
Ligj nr.9810 datë 1.10.2007	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë për transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe mallrave" ……	3767
Ligj nr.9811 datë 1.10.2007	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Federale Austriake për bashkëpunimin policor" ……	3773
Ligj nr.9812 datë 1.10.2007	Për miratimin e "Marrëveshjes minerare të shfrytëzimit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Shoqërisë "Cementos Aguila" sh.p.k." ……	3779
Ligj nr.9813 datë 1.10.2007	Për miratimin e "Marrëveshjes minerare të shfrytëzimit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Shoqërisë "Antea Cement" sh.a." …….	3787

LIGJ
Nr.9809, datë 27.9.2007

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS NR.147 TË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS (ILO) "PËR STANDARDET MINIMALE PËR ANIJET TREGTARE, 1976", SI DHE TË PROTOKOLLIT TË VITIT 1996 TË KONVENTËS "PËR TRANSPORTIN TREGTAR"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Konventa nr.147 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) "Për standardet minimale për anijet tregtare, 1976", si dhe Protokolli i vitit 1996 të Konventës "Për transportin tregtar".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5486, datë 10.10.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

KONVENTA ILO (NR.147) MBI STANDARDET MINIMALE PËR ANIJET TREGTARE
(Gjenevë, 29 tetor 1976)

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës:

e mbledhur në Gjenevë nga Organi Drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës dhe mbajtur në sesionin e gjashtëdhjetë e dytë, më 13 tetor 1976; dhe

duke iu referuar dispozitave të rekomandimeve të angazhimit të detarëve (Mjetet e huaja lundruese), 1958 dhe kushteve sociale dhe rekomandimeve të sigurisë së jetës (të detarëve), 1958; dhe

pasi ka vendosur mbi miratimin e propozimeve të caktuara në lidhje me mjetet lundruese nën nivelet e caktuara, veçanërisht të atyre që janë regjistruar me flamurët përkatës, që është pika e pestë në programin e sesionit; dhe

pasi ka vendosur që këto propozime të marrin formën e një konvente ndërkombëtare,

miraton më njëzet e nëntë tetor të vitit njëmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë konventën e mëposhtme, e cila mund të referohet si Konventa e transportit tregtar (Standardet minimale), 1976:

Neni 1

1. Me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në këtë nen, Konventa zbatohet për çdo anije lundruese në det, pronë shtetërore ose private, e cila përfshihet në transportin e mallrave apo pasagjerëve për qëllime të shkëmbimeve tregtare ose ngarkohet për qëllime të tjera tregtare.

2. Ligjet apo rregulloret kombëtare duhet të përcaktojnë se kur anijet duhet të konsiderohen si anije lundruese në det, në lidhje me qëllimin e kësaj Konvente.

3. Kjo Konventë zbatohet për rimorkime në det.

4. Kjo Konventë nuk zbatohet për:

a) anijet që kryesisht vihen në lëvizje me vela edhe nëse janë të pajisura ose jo me motor ndihmës;

b) anijet e përdorura për peshkim ose në gjueti balenash apo në aktivitete të tjera të ngjashme;

c) mjete të vogla lundrimi ose anije të vogla si anijet naftëmbajtëse dhe platformat manovruese, kur nuk janë të angazhuara në lundrim, vendimi se cilat mjete lundruese parashikohen nga ky nënparagraf që të merren në konsideratë nga organi kompetent në çdo vend, në konsultim me organizatat përfaqësuese të pronarëve të anijeve dhe detarëve.

5. Asgjë në këtë Konventë nuk do të çmohet të zgjerojë fushën e veprimit të konventave, duke iu referuar bashkëlidhjes së kësaj Konvente apo dispozitave në përmbajtje të saj.

Neni 2

Çdo anëtar që ratifikon këtë Konventë ndërmerr:

a) të hartojë ligje ose rregulla për anije të regjistruara në territorin e saj:

i) standarde sigurie, duke përfshirë standarde të kompetencës, orët e punës dhe qëndrimit, për të garantuar sigurinë e jetës në anije;

ii) masat e duhura sociale të sigurisë; dhe

iii) kushtet e punësimit në anije dhe rregullat e jetesës në anije, e sa më sipër, sipas mendimit të anëtarit, nuk janë përfshirë në marrëveshje kolektive ose parashtruar nga gjykatat kompetente në mënyrë njëlloj të detyrueshme për pronarët e anijeve dhe detarëve të interesuar;

dhe të sigurojë se dispozitat e këtyre ligjeve dhe rregullave janë në thelb të barasvlefshme me marrëveshjet ose nenet e konventave, siç referohen në bashkëlidhjen e kësaj Konvente, përsa kohë që anëtari nuk është i detyruar në rastin e kundërt të miratojë Konventën në fjalë;

b) për të ushtruar autoritet\juridiksion efektiv apo kontroll tek anijet, të cilat janë të regjistruara në territorin përkatës përsa i përket:

i) standardeve të sigurta, duke përfshirë standardet me fuqi ligjore, orët e punës dhe plotësimit me ekuipazh, sipas ligjeve apo rregullave kombëtare;

ii) masa të sigurisë sociale sipas ligjeve dhe rregulloreve kombëtare;

iii) kushtet e punësimit në anije dhe caktimi i rregullave të jetesës në bordin e anijes në bazë të ligjeve dhe rregullave kombëtare ose të hartuara nga gjykatat kompetente në mënyrë njëlloj të detyrueshme për pronarët dhe detarët e interesuar;

c) për të arritur që masat e marra për kontrollin efektiv të kushteve të tjera të punësimit dhe rregullave të jetesës në bordin e anijes, në të cilën nuk ka kompetenca efektive, të miratohen nga pronarët e anijeve ose organizatave të tyre dhe organizatave të detarëve, të krijuara në përputhje me dispozitat e pavarura të Konventës së lirisë së asociimit dhe mbrojtjes së të drejtës së organizimit, 1948 dhe Konventën mbi të drejtën për të organizuar dhe atë të marrëveshjes kolektive, 1949;

d) për të siguruar që:

i) procedura të përshtatshme\kompetente, të kushtëzuara nga mbikëqyrja e përgjithshme nga autoritetet kompetente, pas konsultimeve tripalëshe ndërmjet autoriteteve dhe organizatave përfaqësuese të pronarëve të anijeve dhe detarëve, aty ku është e mundur, ekzistojnë për angazhimin e detarëve në anijet e regjistruara në territorin përkatës dhe për hetimin e ankesave që mund të lindin në lidhje me të;

ii) ekzistojnë procedura të mjaftueshme - të kushtëzuara nga mbikëqyrja e përgjithshme nga autoritetet kompetente, pas konsultimeve trepalëshe ndërmjet autoriteteve dhe organizatave përfaqësuese të pronarëve të anijeve dhe detarëve, aty ku është e mundur, për hetimin e çdo ankese të bërë në lidhje me të, dhe kur është e mundur, në kohën e angazhimit, në territorin e vet, të detarëve të kombësisë së tij në anijet e regjistruara në një vend të huaj, dhe se ankesa të tilla, si edhe ankesa të bëra në lidhje me të, dhe nëse është e mundur, në kohën e angazhimit në territoret e detarëve të huaj në anije të regjistruara në një vend të huaj, të raportohen me përpikmëri nga autoritetet kompetente me një kopje drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës të organit kompetent të vendit ku është regjistruar anija;

e) marinarët e punësuar në anijet e regjistruara në territorin e tij të jenë të kualifikuar ashtu si duhet ose të trajnuar për detyra për të cilat ata janë ngarkuar, duke i kushtuar vëmendjen e duhur "Rekomandimeve të trajnimit profesional", 1970;

f) me anë të inspektimit ose mënyrave të tjera të përshtatshme që anijet e regjistruara në territorin e tij të jenë në pajtim me Konventat Ndërkombëtare të Punës në fuqi, të cilat ka ratifikuar, dhe me ligjet dhe rregullat e kërkuara nga nënparagrafi (a) i këtij neni, dhe siç mund të jetë e

përshtatshme sipas ligjit kombëtar, me marrëveshjet e zbatueshme kolektive;

g) të kryejë një hetim zyrtar për çdo aksident të rëndë në det, ku mund të përfshihen anijet e regjistruara në atë territor, veçanërisht ku ka dëme serioze ose/dhe humbje jete, raporti përfundimtar i këtyre lloj hetimeve duhet që normalisht të bëhet publik.

Neni 3

Çdo anëtar që ka ratifikuar këtë Konventë duhet të këshillojë bashkëkombësit e tij për problemet e mundshme, nëse angazhohen në një anije të regjistruar në një shtet, i cili nuk e ka ratifikuar Konventën, derisa të bindet se zbatohen standardet e barasvlefshme me ato të vendosura nga kjo Konventë. Masat e marra nga shteti ratifikues për këtë qëllim nuk duhet të jenë në mospërputhje me parimin e lëvizjes së lirë të punëtorëve, siç është përcaktuar nga traktatet/marrëveshjet në të cilat të dy shtetet e interesuara mund të jenë palë.

Neni 4

1. Nëse një anëtar i cili e ka ratifikuar këtë Konventë dhe në portin e të cilit një anije ndesh gjatë rrjedhës normale të punës së saj ose për arsye operative merr një ankesë, ose siguron fakte se anija nuk përmbush standardet e kësaj Konvente, pasi ajo ka hyrë në fuqi, mund të përgatisë një raport drejtuar qeverisë së vendit në të cilin anija është regjistruar, me një kopje për Drejtorin e Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës, dhe mund të marrë masat e nevojshme për të përmirësuar çdo kusht në bord që duket qartë se është i rrezikshëm për sigurinë dhe shëndetin e njerëzve.

2. Në marrjen e këtyre masave, anëtari duhet të njoftojë menjëherë përfaqësuesin më të afërt bregdetar, konsullor ose diplomatik të shtetit me flamurin përkatës dhe nëse është e mundur, duhet të ketë një përfaqësues të tillë të pranishëm. Nuk duhet të ndalojë ose vonojë anijen pa asnjë arsye.

3. Për qëllime të këtij neni, "ankesë" do të thotë informacion i paraqitur nga një anëtar i ekuipazhit, një organ profesionist, një shoqatë, një sindikatë ose, në përgjithësi, çdo person i interesuar për sigurinë e anijes, duke përfshirë interesimin për sigurinë ose shëndetin që i rrezikohet ekuipazhit të anijes.

Neni 5

1. Kjo Konventë është e hapur për ratifikimin e anëtarëve të cilët:

a) janë palë të Konventës Ndërkombëtare për sigurinë e jetës në det, 1960, ose Konventës Ndërkombëtare për sigurinë e jetës në det, 1974 ose çdo Konvente tjetër që më pas rishikon këto Konventa; dhe

b) janë palë të Konventës ndërkombëtare për linjat e ngarkesës të vitit 1966 ose çdo Konvente tjetër që më pas ka rishikuar atë; dhe

c) janë palë ose kanë zbatuar dispozitat e rregullores për parandalimin e përplasjeve në det të vitit 1960, ose Konventa mbi rregullat ndërkombëtare për parandalimin e përplasjeve në det e vitit 1972, ose çdo konventë që më pas rishikon këto instrumente ndërkombëtare.

2. Kjo Konventë është e hapur edhe ndaj ratifikimit të çdo anëtari tjetër i cili, pas ratifikimit, merr përsipër të përmbushë kërkesat sipas të cilave është bërë ratifikimi si në paragrafin 1 të këtij neni dhe që nuk janë plotësuar ende.

3. Ratifikimet zyrtare të kësaj Konvente duhet t'i paraqiten Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për regjistrim.

Neni 6

1. Kjo Konventë duhet të jetë e detyrueshme vetëm për ata anëtarë të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, ratifikimet e të cilëve janë regjistruar nga Drejtori i Përgjithshëm.

2. Konventa hyn në fuqi 12 muaj pas datës në të cilën janë regjistruar ratifikimet nga të paktën 10 anëtarë me një total aksionesh në transportin detar botëror prej 25 për qind të tonazhit bruto.

3. Pas kësaj, kjo Konventë hyn në fuqi për çdo anëtar 12 muaj pas datës në të cilën është

regjistruar ratifikimi i saj.

Neni 7

1. Një anëtar, i cili e ka ratifikuar këtë Konventë mund ta denoncojë atë vetëm pas 10 vjetësh që nga data kur Konventa ka hyrë në fuqi për herë të parë, me anë të një akti drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për regjistrim. Ky denoncim nuk do të merret në konsideratë pa u mbushur një vit që nga data kur ajo është regjistruar.

2. Çdo anëtar që e ka ratifikuar këtë Konventë dhe që brenda vitit pasardhës të përfundimit të periudhës prej 10 vitesh të përmendura në paragrafin e mësipërm, nuk e ushtron të drejtën e denoncimit, siç është parashikuar në këtë nen, do të lejohet për një periudhë tjetër 10-vjeçare dhe më pas, mund ta denoncojë këtë Konventë në përfundim të çdo periudhe prej 10 vitesh, në bazë të kushteve të parashikuara nga ky nen.

Neni 8

1. Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës duhet t'i njoftojë të gjithë anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Punës për regjistrimin e të gjitha ratifikimeve dhe denoncimeve, komunikuar atij nga anëtarët e Organizatës.

2. Kur të plotësohen kushtet e përmendura më sipër në nenin 6, paragrafi 2, Drejtori i Përgjithshëm u tërheq vëmendjen anëtarëve të Organizatës për datën në të cilën Konventa do të hyjë në fuqi.

Neni 9

Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës duhet t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara regjistrimin në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, një raport të plotë e të hollësishëm mbi të gjitha ratifikimet dhe aktet e denoncimit, të regjistruara nga vetë ai në përputhje me dispozitat e neneve të mëparshme.

Neni 10

Në kushte të tilla, është e nevojshme që Organi Drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës duhet t'i paraqesë Konferencës së Përgjithshme një raport mbi punimet e kësaj Konvente dhe të shqyrtojë vullnetin e vendosjes së çështjes së rishikimit të saj të plotë ose të pjesshëm në programin e Konferencës.

Neni 11

1. Në rast se Konferenca miraton një konventë të re duke rishikuar pjesërisht ose tërësisht këtë Konventë, përsa kohë që konventa e re nuk parashikon ndryshe:

a) ratifikimi nga ndonjë anëtar i Konventës së re të rishikuar *de jure* përfshin denoncimin e menjëhershëm të kësaj Konvente, pavarësisht nga dispozitat e nenit 7 më sipër, nëse dhe kur Konventa e re e rishikuar duhet të ketë hyrë në fuqi;

b) që nga data kur Konventa e re e rishikuar hyn në fuqi, kjo Konventë duhet të ndalojë së qenuri e hapur për ratifikim nga anëtarët.

2. Kjo Konventë mbetet në çdo rast në fuqi në formën dhe përmbajtjen e saj aktuale për ata anëtarë të cilët e kanë ratifikuar atë, por që nuk kanë ratifikuar Konventën e rishikuar.

Neni 12

Versionet në gjuhën angleze dhe frënge të tekstit të kësaj Konvente janë njëlloj të barasvlefshme.

SHTOJCË

Konventa me afat minimal, 1973 (nr.138); ose
Konventa me afat minimal (për hapësirat ujore) (e rishikuar), 1936 (nr.58); ose
Konventa me afat minimal (për hapësirat ujore), 1920 (nr.7);
Konventa mbi përgjegjësinë e pronarëve të anijeve (Marinarë të sëmurë ose të dëmtuar), 1936 (nr.55); ose
Konventa për sigurime shëndetësore (në det), 1936 (nr.56); ose
Konventa mbi kujdesin mjekësor dhe shpërblim me siguracion, 1969 (nr.130);
Konventa e kontrollit mjekësor (e detarëve), 1970 (nr.134) (nenet 4 dhe 7);

Konventa e strehimit të ekuipazhit (e rishikuar), 1949 (nr.92);
Konventa e ushqimit dhe e furnizimit me ushqime (ekuipazhi i anijes), 1946 (nr.68) (neni 5);
Konventa e certifikimit të aftësive\profesionalizmit të oficerëve, 1936 (53) (nenet 3 dhe 4);
Konventa me nenet e marrëveshjes së detarëve, 1926 (nr.22);
Konventa e riatdhesimit të detarëve, 1926 (nr.23);
Konventa e lirisë së asociimit (marrjes pjesë në një shoqatë) dhe mbrojtjes së të drejtës së organizimit, 1948 (nr.87);
Konventa mbi të drejtën e organizimit dhe marrëveshjes kolektive, 1949 (nr.98).

1. Në rastet kur sistemi i caktuar i licencimit ose struktura e certifikimit të një shteti do të cenohej nga probleme që lindin nga zbatimi i saktë i standardeve përkatëse të Konventës së certifikimit të aftësive\profesionalizmit të oficerëve, 1936, atëherë zbatohet parimi i barasvlefshmërisë, prandaj nuk do të ketë asnjë konflikt në lidhje me marrëveshjen e parashtruar të shteteve për certifikim.

PROTOKOLLI I VITIT 1996
PËR TRANSPORTIN TREGTAR (STANDARDET MINIMALE),
I KONVENTËS SË VITIT 1976

Protokolli i vitit 1996 për transportin tregtar (Standardet minimale), i Konventës së vitit 1976
(Shënim: Data e hyrjes në fuqi: 10.1.2003)
Konventa: P147

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës:

e mbledhur në Gjenevë nga Organi Drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës dhe mbajtur në sesionin e tetëdhjetë e katërt të saj, më 8 tetor 1996; dhe

në bazë të dispozitave të nenit 2 të Konventës së transportit tregtar (Standardet minimale), 1976 (e referuar këtu e tutje si "Konventa kryesore"), e cila në disa pjesë nënvizon se:

"Çdo anëtar që ratifikon këtë Konventë ndërmerr:

a) të hartojë ligje ose rregulla për anije të regjistruara në territorin e tij:

i) standarde sigurie, duke përfshirë standarde të kompetencës, orët e punës dhe pajisja me ekuipazh, për të garantuar sigurinë e jetës në anije;

ii) masat e duhura sociale të sigurisë; dhe

iii) kushtet e punësimit në anije dhe rregullat e jetesës në anije, e sa më sipër, sipas mendimit të anëtarit, nuk përfshihen në marrëveshjet kolektive ose parashtrimet e gjykatave kompetente në mënyrë njëlloj të detyrueshme për pronarët e anijes dhe detarët e interesuar; dhe

të sigurojë se dispozitat e këtyre ligjeve dhe rregullave janë në thelb të barasvlefshme me marrëveshjet ose nenet e konventave, siç referohen në shtojcën e kësaj Konvente, përsa kohë që anëtari nuk është i detyruar ta miratojë ndryshe Konventën në fjalë"; dhe

duke marrë parasysh dispozitat e nenit 4, paragrafi 1 të Konventës kryesore, e cila nënvizon se:

"Në rast se një anëtar, i cili e ka ratifikuar këtë Konventë dhe në portin e të cilit kryen kursin normal të ditës ose për arsye operative merr letërankesë ose siguron fakte se anija nuk përmbush standardet e kësaj Konvente, pasi ajo ka hyrë në fuqi, ai mund të përgatisë një raport drejtuar qeverisë

së vendit ku është regjistruar anija, me një kopje drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës dhe mund të marrë masat e nevojshme për të rregulluar kushtet në kuvertë, të cilat mund të jenë të rrezikshme për sigurinë e jetës ose të shëndetit"; dhe

duke iu referuar Konventës së diskriminimit (në punësim dhe profesion) të vitit 1958, neni 1, paragrafi 1, e cila nënvizon se:

"Për qëllime të kësaj Konvente termi diskriminim përfshin:

a) çdo dallim, përjashtim ose preferencë të bërë në bazë të racës, ngjyrës, seksit, fesë, bindjeve politike, prejardhjes kombëtare apo origjinës sociale, që ndikon në anulimin ose mungesën e mundësive apo trajtimit të barabartë në punësim apo profesion;

b) dallime të tjera të këtij lloji, përjashtim ose preferencë e cila ndikon në anulimin ose mungesën e mundësive apo trajtimit të barabartë në punësim apo profesion, siç mund të përcaktohet nga anëtari i interesuar pas konsultimit me përfaqësuesit e punëdhënësve dhe organizatat e punëtorëve, atje ku ekzistojnë të tilla, si edhe konsultimeve me organe të tjera përkatëse"; dhe

duke iu referuar hyrjes në fuqi të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi ligjin e hapësirave ujore\detare në vitin 1982, më 16 nëntor 1994; dhe

duke iu referuar Konventës Ndërkombëtare të Organizatës Ndërkombëtare Detare mbi standardet e trajnimit, certifikimit dhe vrojtimit të lundërtarëve në 1978 dhe amenduar në 1995;

pasi ka vendosur për miratimin e propozimeve të caktuara, përsa i përket rishikimit të pjesshëm të Konventës kryesore, e cila përbën pikën e katërt të programit të sesionit; dhe

pasi ka vendosur se këto propozime duhet të marrin formën e një protokolli për Konventën kryesore,

miraton, më 22 tetor 1996 protokollin e mëposhtëm, i cili mund të përmendet si Protokolli i vitit 1996 i Konventës për transportin tregtar (standardet minimale), 1976:

Neni 1

1. Çdo anëtar, i cili ratifikon këtë Protokoll duhet të zgjerojë listën e Konventave që shfaqen në shtojcën e Konventës kryesore dhe që përfshijnë konventat në pjesën A të shtojcës plotësuese dhe atyre konventave që janë renditur në pjesën B të shtojcës, siç i pranon, nëse ka të tilla, në përputhje me nenin 3 më poshtë.

2. Zgjerimi i Marrëveshjes së renditur në pjesën A të shtojcës plotësuese, që nuk është ende në fuqi duhet të aplikohet vetëm kur Marrëveshja të hyjë në fuqi.

Neni 2

Një anëtar mund ta miratojë këtë Protokoll në të njëjtën kohë ose në çfarëdo kohe pasi të miratojë Marrëveshjen kryesore, duke i komunikuar ratifikimin formal të Protokollit Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për regjistrimin.

Neni 3

1. Çdo anëtar që miraton këtë Protokoll duhet, në ato raste kur është e zbatueshme, të cilësojë në një deklaratë që shoqëron instrumentin e ratifikimit\miratimit, se cilën konventë apo cilat konventa të renditura në pjesën B të shtojcës plotësuese pranon.

2. Një anëtar, i cili nuk i ka pranuar të gjitha konventat e renditura në pjesën B të shtojcës plotësuese mundet që, me një deklaratë shoqëruese drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës, të saktësojë se cilën apo cilat konventa pranon.

Neni 4

1. Për qëllime të nenit 1, paragrafi 1 dhe nenit 3 të këtij Protokolli, organi kompetent duhet të zhvillojë më parë konsultime me organizatat përfaqësuese të pronarëve dhe marinarëve të anijeve.

2. Organi kompetent duhet që sa më shpejt të jetë e mundur, të vërë në dispozicion të organizatave përfaqësuese të pronarëve dhe marinarëve të anijeve, informacion në lidhje me ratifikimet, deklaratat dhe denoncimet e marrëveshjeve të njoftuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës, në përputhje me nenin 8, paragrafi 1, si më poshtë.

Neni 5

Për qëllime të këtij Protokolli, Konventa e riatdhesimit të marinarëve (e rishikuar), 1987, duhet në rastet kur një anëtar i cili e pranon Konventën, të konsiderohet si zëvendësim i Konventës së riatdhesimit të detarëve, 1926.

Neni 6

1. Ky Protokoll është i detyrueshëm vetëm për ata anëtarë të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, ratifikimi i të cilëve është regjistruar pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës.

2. Ky Protokoll hyn në fuqi 12 muaj pas datës së regjistrimit të ratifikimeve nga pesë anëtarët, tre prej të cilëve kanë të paktën një milion tonazh bruto me ngarkesë.

3. Pas kësaj, ky protokoll hyn në fuqi për çdo anëtar, 12 muaj pas datës kur është regjistruar ratifikimi i tij.

Neni 7

Një anëtar i cili e ka ratifikuar këtë Protokoll, mund ta shpallë atë të pavlefshëm, për aq kohë sa Konventa kryesore është e hapur ndaj denoncimit në përputhje me nenin 7, me anë të një akti\dokumenti që i drejtohet Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për regjistrim.

Neni 8

1. Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës duhet t'i njoftojë të gjithë anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Punës për regjistrimin e ratifikimeve, deklaratave dhe akteve të denoncimit drejtuar anëtarëve të Organizatës.

2. Kur plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 6, paragrafi 2, si më sipër, Drejtori i Përgjithshëm i tërheq vëmendjen anëtarëve të Organizatës për datën kur Protokolli duhet të hyjë në fuqi.

Neni 9

Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës i komunikon Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, në kontekstin e regjistrimeve në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, detajet e plota të të gjitha ratifikimeve dhe akteve të denoncimit, regjistruar nga Drejtori i Përgjithshëm në përputhje me dispozitat e neneve të mëparshme.

Neni 10

Për aq kohë sa mund të çmohet e nevojshme, Organi Drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës duhet t'i paraqesë Konferencës së Përgjithshme një raport mbi punimet e këtij Protokolli dhe të shqyrtojë vullnetin e vendosjes së çështjes së rishikimit të tij të plotë ose të pjesshëm në programin e Konferencës.

Neni 11

Për qëllime të rishikimit të këtij Protokolli dhe mbylljes me ratifikimin e tij, do të aplikohen *mutatis mutandis* dispozitat e nenit 11 të Konventës kryesore.

Neni 12

Versionet në gjuhën angleze dhe frënge të tekstit të këtij Protokolli janë njëlloj të barasvleshme.

SHTOJCA
SHTOJCA PLOTËSUESE

PJESA A

Konventa për strehimin e ekuipazhit (dispozita plotësuese), 1970 (nr.133) dhe Konventa e orëve të punës së detarëve dhe për pajisjen me ekuipazh të anijeve, 1996 (nr.180).

PJESA B

Konventa e dokumenteve të identitetit të detarëve, 1958 (nr.108);
Konventa e përfaqësuesve të punëtorëve, 1971 (nr.135);
Konventa për mbrojtjen e shëndetit dhe kujdesit shëndetësor (të detarëve), 1987 (nr.164);
Konventa e riatdhesimit të detarëve (e rishikuar), 1987 (nr.166).

LIGJ
Nr.9810, datë 1.10.2007

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SLLOVENISË PËR TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË UDHËTARËVE DHE MALLRAVE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë për transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe mallrave".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5487, datë 10.10.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SLLOVENISË MBI TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË UDHËTARËVE DHE MALLRAVE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Sllovenisë, këtu e tutje të referuara si Palë Kontraktuese:

me dëshirën për të kontribuar për zhvillimin e marrëdhënieve tregtare dhe ekonomike midis dy vendeve;

të vendosur për të nxitur bashkëpunimin e transportit rrugor në kuadër të ekonomisë së tregut;

të shqetësuar për mbrojtjen e mjedisit dhe njerëzve, përdorimin racional të energjisë, sigurinë në rrugë dhe përmirësimin e kushteve të punës së drejtuesve të automjeteve;

duke synuar drejt zhvillimit të modaliteteve të transportit rrugor;

duke njohur avantazhin e dyanshëm të zhvillimit të transportit rrugor,

kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje shërbejnë për transportin rrugor të mallrave dhe udhëtarëve midis territoreve të Palëve Kontraktuese, në transit ndërmjet territoreve të tyre dhe për në ose nga vendet e treta të kryera nga transportues të vendosur në territorin e njërës nga Palët Kontraktuese.

Kjo Marrëveshje nuk cenon të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare që kanë firmosur Palët Kontraktuese.

Neni 2
Përkufizime

Termat e përdorura në këtë Marrëveshje kanë kuptimet e mëposhtme:

1. "Operator transporti" nënkupton çdo person fizik ose juridik i vendosur në territorin e njërës prej Palëve Kontraktuese dhe i autorizuar për të kryer transportin e udhëtarëve ose mallrave.

2. "Mjet transporti" nënkupton një automjet ose kombinim automjetesh ku të paktën automjeti është regjistruar në territorin e njërës nga Palët Kontraktuese dhe që përdoret dhe është i pajisur ekskluzivisht për transportimin e udhëtarëve ose mallrave.

3. "Transport" nënkupton lëvizjen e automjetit, të ngarkuar ose të pangarkuar, edhe nëse automjeti, rimorkiuesi ose gjysmërimorkio transportohet me tren ose anije për një pjesë të udhëtimit.

4. "Kabotazh" nënkupton transport të udhëtarëve ose mallrave që kryhet nga një operator transporti i vendit të njërës Palë Kontraktuese ndërmjet pikave të veçanta brenda territorit të Palës tjetër Kontraktuese.

5. "Territori i njërës Palë Kontraktuese" nënkupton përkatësisht territorin e Republikës së Sllovenisë dhe territorin e Republikës së Shqipërisë.

6. "Vendi i vendosjes" nënkupton territorin e Palës Kontraktuese brenda të cilit është vendosur operatori i transportit dhe automjeti i regjistruar.

7. "Vendi pritës" nënkupton territorin e Palës Kontraktuese në të cilin operatori i transportit operon pa automjetin e tij të regjistruar atje dhe pa operatorin e transportit të vendosur atje.

8. "Autobus" nënkupton një automjet të regjistruar në territorin e njërës prej Palëve Kontraktuese dhe në bazë të konstruksionit e pajisjeve të përshtatshme dhe i caktuar për transportin e udhëtarëve, që përveç sediljes së shoferit, ka më shumë sesa tetë vende të tjera për udhëtarët.

9. "Shërbimi i rregullt i udhëtarëve" nënkupton një shërbim, ku udhëtarët transportohen në një linjë të caktuar sipas orarit dhe tarifave të përcaktuara e shpallura më parë. Udhëtarët merren ose zbriten në vendndalime të paracaktuara më parë.

10. "Shërbimi vajtje-ardhje" nënkupton një shërbim, ku me anë të udhëtimeve të përsëritura vajtje-ardhje, grupe udhëtarësh të formuara më parë, transportohen nga një vend i vetëm i nisjes në një vend të vetëm të destinacionit. Secili grup, i përbërë nga udhëtarë që bënin rrugën në vajtje, kthehet në vendin e nisjes në një udhëtim të mëvonshëm. Vendi i nisjes dhe ai i destinacionit do të thotë përkatësisht vendi ku fillon udhëtimi dhe vendi ku përfundon ai, bashkë me mjedisin përreth brenda një rrezeje prej 50 km.

Shërbimi vajtje-ardhje mund të përfshijë akomodimin e pasagjerëve në destinacion dhe, kur është e nevojshme, gjatë udhëtimit.

Udhëtimi i parë në kthim dhe ai i fundit në vajtje në një seri udhëtimesh vajtje-ardhje kryhet pa ngarkesë.

11. "Shërbimi i rastit" nënkupton një shërbim që nuk përfshihet as në përkufizimin e

shërbimit të rregullt të udhëtarëve e as në përkufizimin e shërbimit vajtje-ardhje. Frekuenca ose numri i shërbimeve nuk ndikon te klasifikimi i tyre si shërbime të rastit.

12. "Dokumenti i kontrollit" nënkupton listën e udhëtarëve për autobusin, në përputhje me modelin e rënë dakord nga Komiteti i Përbashkët, referuar në nenin 14 të kësaj Marrëveshjeje.

13. "Autorizimi\leja" nënkupton dokumentin, e lëshuar nga organi kompetent i secilës prej Palëve Kontraktuese që garanton të drejtën\mundësinë që automjeti i regjistruar në territorin e Palës tjetër Kontraktuese të udhëtojë në ose brenda territorit të Palës Kontraktuese ku është lëshuar autorizimi\leja.

14. "Transiti" nënkupton transportin e udhëtarëve dhe\ose mallrave nga automjeti i regjistruar në territorin e njërës prej Palëve Kontraktuese përmes territorit të Palës tjetër Kontraktuese.

15. Termi "Mallra të rrezikshme" nënkupton mallra që për nga cilësia, vetitë dhe tiparet e tyre karakteristike, kur transportohen, ngarkohen, shkarkohen dhe magazinohen, mund të shkaktojnë dëme te pajisjet elektronike, pajisjet, ndërtesat dhe ndërtimet, si dhe të shkaktojnë vdekjen, plagosjen ose sëmundjen e njerëzve, kafshëve dhe të shkaktojnë dëme të tjera në mjedis.

PJESA II
TRANSPORTI I UDHËTARËVE

Neni 3
Shërbim i rregullt

1. Shërbimet e rregullta të udhëtarëve, që kryhen ndërmjet territoreve të Palëve Kontraktuese ose në transit përmes territoreve të tyre, i nënshtrohen sistemit të autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente të Palëve Kontraktuese.

2. Aplikimi për autorizime duhet të bëhet në organin kompetent në vendin e vendosjes së operatorit të transportit. Nëse organi kompetent aprovon aplikimin, autorizimi i komunikohet organit kompetent të Palës tjetër Kontraktuese.

Komiteti i Përbashkët, i ngritur në bazë të nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje si më poshtë, vendos për formularin e aplikimit të autorizimit dhe dokumentet plotësuese të nevojshme.

3. Autorizimet lëshohen nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese sipas Marrëveshjes së përbashkët.

Vendimi për të dhënë ose refuzuar lëshimin e autorizimit merret brenda një kohe prej tre muajsh, me përjashtim të rasteve të veçanta.

Autorizimet janë të vlefshme për një maksimum kohe prej pesë vjetësh. Ato përcaktojnë kushtet operuese, duke përfshirë standardet e sigurisë dhe mjedisit që duhet të respektojnë automjetet.

4. Ndryshimet e kushteve operuese dhe anulimi i shërbimit vendoset sipas procedurave të përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni.

Në rast se nuk ka më kërkesa për këtë shërbim, operatori mund ta anulojë atë, duke njoftuar tre muaj më parë organin kompetent, i cili e ka lëshuar autorizimin dhe klientët.

Neni 4
Shërbimet e rastit dhe vajtje-ardhje

1. Shërbimet e rastit dhe vajtje-ardhje të udhëtarëve, që kryhen ndërmjet territoreve të Palëve Kontraktuese dhe në transit përmes territoreve të tyre, i nënshtrohen sistemit të lejeve të lëshuara nga organet kompetente të Palëve Kontraktuese.

Komiteti i Përbashkët i ngritur sipas nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje bie dakord për kërkesat e standardeve teknike, mjedisore dhe të sigurisë që duhet të plotësojnë automjetet që kryejnë transportin siç është parashikuar nga ky nen.

2. Si përjashtim i paragrafit 1 të këtij neni, shërbimet e renditura më poshtë janë përjashtuar nga sistemi i lejeve në territorin e vendit pritës:

a) udhëtime me dyer të mbyllura ku i njëjti automjet përdoret për të transportuar të njëjtin grup udhëtarësh gjatë gjithë udhëtimit dhe i sjell ata në vendin e nisjes;

b) shërbime që e nisin udhëtimin jashtë me ngarkesë dhe e kryejnë kthimin pa ngarkesë;

c) shërbime që e nisin udhëtimin jashtë pa ngarkesë dhe e bëjnë kthimin me ngarkesë, duke pasur parasysh që udhëtarët janë kthyer më parë me të njëjtin mjet transporti në territorin e Palës Kontraktuese, ku janë marrë përsëri dhe transportuar në territorin e vendit të vendosjes.

3. Marrja e udhëtarëve në një udhëtim me shërbim të liberalizuar nuk lejohet pa u dhënë leje e veçantë.

Komiteti i Përbashkët i ngritur në bazë të nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje aktuale mund të zgjerojë përjashtimet në leje të kategorive të tjera të shërbimeve të rastit.

4. Aplikimi i lejes bëhet në organin kompetent të vendit pritës. Komiteti i Përbashkët i ngritur në bazë të nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje vendos për formularin e aplikimit të lejes, si dhe të dokumenteve plotësuese të nevojshme.

5. Shërbimet e rastit të përjashtuara nga kërkesat për leje dhe të kryera me anë të autobusëve duhet të pasqyrohen me një dokument kontrolli. Kushtet e përdorimit dhe përmbajtja e dokumentit të kontrollit parashtrohen nga Komiteti i Përbashkët, siç i referohemi nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

Dispozita të përgjithshme të shërbimit të udhëtarëve

1. Lejet e transportit nuk janë të transferueshme për operatorë të tjerë transporti.

2. Ndalohet kryerja e shërbimeve të kabotazhit.

PJESA III

TRANSPORTI I MALLRAVE

Neni 6

Sistemi i lejeve

1. Operatorët e transportit të vendosur në territorin e Palës Kontraktuese, sipas sistemit të lejeve universale, mund të ndërmarrin:

a) Transportin ndërmjet territoreve të të dyja Palëve Kontraktuese;

b) Transportin transit;

c) Transportin ndërmjet një pike në territorin e Palës tjetër Kontraktuese dhe një pike në territorin e një vendi të tretë, nëse itinerari kalon përmes territorit të vendit ku është regjistruar automjeti.

2. Transporti ndërmjet një pike në territorin e Palës tjetër Kontraktuese dhe një pike në territorin e një vendi të tretë, kryhet me një leje të veçantë, në rast se itinerari nuk kalon në territorin e vendit të regjistrimit.

3. Kabotazhi lejohet vetëm me autorizim të veçantë të vendit pritës.

4. Komiteti i Përbashkët i ngritur në bazë të nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje përcakton lloje të tjera të lejeve. Në rast se është e nevojshme, ai mund të paraqesë propozime për kryerjen e transportit pa leje.

Neni 7

Përjashtime nga kërkesa për leje

1. Lejet siç parashikohen në nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje nuk nevojiten për:

a) transportin me automjete pesha totale e lejuar e ngarkesës [PTLN] e të cilave, duke përfshirë edhe rimorkion, nuk e kalon 6 tonë ose kur ngarkesa e lejuar e mallit, duke përfshirë rimorkion nuk e kalon 3,5 tonë;

b) transportin sipas rastit për në ose nga aeroportet në rastet kur ka devijime të shërbimeve ajrore;

c) transportin e automjeteve që janë dëmtuar ose kanë dalë jashtë përdorimit dhe udhëtimet e mjeteve për riparimin e tyre;

d) udhëtimet pa ngarkesë të automjetit të mallrave të dërguar për zëvendësimin e automjetit të dëmtuar, si dhe kthimin e tij, pas riparimit të automjetit të dëmtuar;

e) transportin e mjeteve dhe pajisjeve mjekësore të nevojshme në raste urgjence, në mënyrë të veçantë për rastet e fatkeqësive natyrore dhe, gjithashtu për të dhënë një ndihmë humanitare;

f) transportin e veprave dhe objekteve të artit për panaire dhe ekspozita ose për qëllime jotregtare;

g) transportin për qëllime jotregtare të pasurive, aksesorëve dhe kafshëve për në dhe nga shfaqje dhe panaire teatrore, muzikore, filma, sporte ose cirku, dhe ato që janë të destinuara për regjistrime në radio ose prodhime filmike apo televizive;

h) heqje të pajisjeve shtëpiake të kryera nga kompani me personel të specializuar dhe pajisjeve për këtë qëllim;

i) transportin funeral;

j) transportin postar.

2. Komiteti i Përbashkët i ngritur në bazë të nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje, mund të shtojë ose të heqë, nga lista e kategorive të transportit të përjashtuara nga kërkesat e lejeve.

Neni 8

Dispozita të përgjithshme për transportin e mallrave

1. Organet kompetente të të dyja Palëve Kontraktuese shkëmbejnë një numër formularësh bosh për leje çdo vit, siç është rënë dakord.

Lejet duhet të jenë të vlefshme deri më 31 janar të vitit të ardhshëm kalendarik.

2. Lejet nuk janë të transferueshme për operatorë të tjerë transporti.

3. Lejet mund të përdoren vetëm një herë për një automjet. Në rastin e automjeteve të kombinuara, automjeti motorik (tërheqësi) është faktori përcaktues për lëshimin ose jo të lejes.

4. Komiteti i Përbashkët i ngritur në bazë të nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje vendos kuotën, kategorinë dhe kushtet e tjera që përcaktojnë mënyrën e përdorimit të lejes.

PJESA IV

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 9

Tatimet dhe taksat

1. Automjetet që realizojnë transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave, udhëtarëve dhe bagazheve të tyre e që janë regjistruar në territorin e Palës Kontraktuese dhe që ndodhen përkohësisht në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, përjashtohen nga pagesa e taksave lidhur me pronësinë, regjistrimin dhe drejtimin e automjetit sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje.

2. Karburanti (jo më shumë se 200 litra për automjetet që transportojnë mallra dhe jo më shumë se 600 litra për autobusë) i mbajtur normalisht në serbatorët e vendosur në automjetet nga prodhuesi me qëllim përdorimi mjeti, si dhe vajrat e pjesët e këmbimit përjashtohen nga të gjitha tatim taksat doganore, në përputhje me legjislacionin kombëtar të vendit pritës.

Pjesët e këmbimit të papërdorura duhet të eksportohen nga vendi dhe pjesët e zëvendësuara, duhet të eksportohen ose eliminohen në prani të nëpunësve të doganës së Palës përkatëse Kontraktuese.

3. Transporti, sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje, parashikon pagesën e tarifave të përdorimit të rrugës, si dhe taksave të lëshuara për përdorimin e rrjetit rrugor ose urave në vendin pritës. Taksat dhe tarifat vihen pa dallim për operatorët e transportit të të dy vendeve të Palëve Kontraktuese.

Neni 10

Pesha dhe përmasat

1. Pesha maksimale e lejuar, pesha për akset dhe dimensionet e automjeteve nuk duhet të kalojnë ato të shënuara në dokumentet e regjistrimit dhe as kufijtë më të lartë të lejueshëm në fuqi, në vendin pritës.

2. Përdorimi i automjeteve, peshat dhe përmasat e të cilave i kalojnë kufijtë maksimalë të

lejueshëm, lejohet në vendin pritës vetëm me autorizim të veçantë të lëshuar paraprakisht.

Neni 11
Pajisjet dhe karakteristikat e tjera

1. Automjetet që transportojnë mallra të rrezikshme duhet të jenë të përshtatshme dhe të pajisura, në përputhje me kërkesat e Marrëveshjes Europiane lidhur me transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme të 30 shtatorit 1957, siç është ndryshuar (ADR).

2. Pajisjet që përdoren për të kontrolluar mënyrën e drejtimit të automjetit dhe kohëqëndrimet duhet të përputhen me dispozitat e Marrëveshjes Europiane lidhur me punën e ekuipazheve të automjeteve të angazhuar në transportin ndërkombëtar rrugor të 1 korrikut 1970, siç është ndryshuar (AETR).

3. Palët Kontraktuese ndërmarrin të promovojnë përdorimin e mjeteve që plotësojnë standardet e sigurisë dhe mjedisit.

Neni 12
Kontrolli

Lejet, autorizimet, kontrolli i dokumenteve dhe çdo dokument tjetër në bazë të kësaj Marrëveshjeje, si dhe mandatet e dorëzimit, listës së udhëtarëve, siguracionet, certifikatat e trajnimit dhe të gjitha dokumentet e tjera të kërkuara në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të vendeve të Palëve Kontraktuese, që janë firmosur dhe/ose sipas legjislacionit të vendeve të Palëve Kontraktuese, duhet të mbahen në automjet dhe të tregohen me kërkesën e nëpunësve të autorizuar.

Neni 13
Detyrimet e operatorëve të transportit dhe shkeljet

1. Operatorët e transportit të vendit të Palës Kontraktuese dhe ekuipazhet e automjeteve duhet të veprojnë në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi të atij vendi, kur janë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

2. Në rast të ndonjë shkeljeje të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nga operatori i transportit të vendit të Palës Kontraktuese, autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese në territorin e të cilës ndodhi shkelja, pa paragjykuar procedimet ligjore të atij vendi, duhet të njoftojë autoritetin kompetent të Palës tjetër Kontraktuese, i cili do të marrë masa siç janë parashikuar nga legjislacioni kombëtar i atij vendi. Në raste veçanërisht të rënda, autoriteti kompetent i vendit pritës mund të ndalojë përkohësisht hyrjen në territorin e vendit të tij duke pritur një vendim nga organi kompetent në vendin e vendndodhjes. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese duhet ta informojnë njëri-tjetrin reciprokisht për vendimet e marra.

Neni 14
Komiteti i Përbashkët

1. Me qëllim zbatimin ashtu si duhet të Marrëveshjes aktuale dhe trajtimin e çështjeve lidhur me të, do të ngrihet një Komitet i Përbashkët me përfaqësues nga organet kompetente të Palëve Kontraktuese.

2. Kur është e nevojshme mund të marrin pjesë përfaqësues të autoriteteve të tjera.

Neni 15
Autoritetet kompetente

1. Autoritetet kompetente për implementimin e kësaj Marrëveshjeje janë:

Në Republikën e Shqipërisë: Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

Në Republikën e Sllovenisë: Ministria e Transportit të Republikës së Sllovenisë.

Në rast ndryshimesh të autoriteteve kompetente siç është shprehur në këtë paragraf, emrat e autoriteteve kompetente u komunikohen Palës tjetër Kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike.

PJESA V
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 16
Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim me anë të të cilit Palët Kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën që procedurat e tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi kanë përfunduar.

2. Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi për një periudhë kohe të pacaktuar. Secila nga Palët Kontraktuese mund ta përfundojë atë me anë të një njoftimi me shkrim. Marrëveshja zgjidhet tre muaj pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar, siç duhet për këtë, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në……më……..në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

LIGJ
Nr.9811, datë 1.10.2007

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË FEDERALE AUSTRIAKE PËR BASHKËPUNIMIN POLICOR"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Federale Austriake për bashkëpunimin policor".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5488, datë 10.10.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË FEDERALE AUSTRIAKE MBI BASHKËPUNIMIN POLICOR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria Federale Austriake, të quajtura në vazhdim Palë Kontraktuese:

- *duke synuar* të kontribuojnë për zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe;
- *të sigurt* se bashkëpunimi në luftën ndaj krimit ndërkombëtar është me rëndësi për të dy shtetet;
- *të shqetësuar* nga rreziku i përhapjes së tregtimit ilegal të drogave dhe substancave psikotrope dhe të formave të tjera të krimit ndërkombëtar, që vënë në rrezik sigurinë ose interesa të

tjera thelbësore të të dy shteteve;

- *me qëllimin* për të koordinuar aktivitetet e tyre në luftën kundër krimit ndërkombëtar të organizuar dhe migracionit ilegal;

- *duke u nisur* nga konventa e vetme mbi drogat narkotike të datës 30 mars 1961 në versionin e protokollit të datës 25 mars 1972, me të cilin u ndryshua konventa e vetme mbi drogat narkotike nga konventa mbi substancat psikotrope të datës 21 shkurt 1971, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe të substancave psikotrope të datës 20 dhjetor 1988, si edhe nga Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkufitar të datës 15 nëntor 2000;

- *duke marrë parasysh* Konventën e Këshillit të Europës të datës 28 janar 1981 për mbrojtjen e njeriut në përpunimin automatik të të dhënave personale (ETS 108), protokollin shtesë të datës 23 maj 2001, si edhe rekomandimin nr.R (87) 15 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës të datës 17 shtator 1987 për rregullimin e përdorimit të të dhënave personale nga ana e policisë, duke përfshirë edhe të dhënat që nuk përpunohen në mënyrë të automatizuar,

ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

Fushat dhe qëllimi i bashkëpunimit

Palët Kontraktuese marrin përsipër të bashkëpunojnë dhe të japin ndihmë zyrtare, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar, nëpërmjet autoriteteve kompetente të përcaktuara në këtë Marrëveshje në mbrojtjen kundër rreziqeve për sigurinë dhe rendin publik, si edhe në parandalimin dhe zbulimin e veprave të dënueshme nga ana e gjykatave. Ky bashkëpunim përfshin në veçanti fushat e mëposhtme:

1. Mbjelljen ilegale, prodhimin, importin, eksportin ilegal, transportin dhe tregtimin ilegal të drogave narkotike, të substancave psikotrope dhe të prekursorëve;

2. Terrorizmin ndërkombëtar;

3. Forma të tjera të krimit ndërkombëtar të organizuar, duke përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore dhe migracionin ilegal, krimin kundër pronës, krimin ekonomik dhe pastrimin e parave.

Neni 2

Format e bashkëpunimit

1. Bashkëpunimi i autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese, në kuptimin e kësaj Marrëveshjeje kryhet në përputhje me legjislacionin kombëtar përkatës, si edhe në kuadrin e fushës përkatëse të kompetencës dhe përfshin në veçanti:

1. Informimin reciprok mbi rrethanat, njohja e të cilave mund të kontribuojë për mbrojtjen ndaj rreziqeve për sigurinë dhe rendin publik, si edhe për parandalimin dhe zbulimin e veprave të dënueshme nga ana e gjykatës; transmetimi i të dhënave personale lejohet vetëm, nëse kjo është e nevojshme për mbrojtjen ndaj rreziqeve të lartpërmendura, si edhe për zbulimin e veprave të lartpërmendura;

2. Përkrahjen reciproke në kërkimin e personave dhe në kërkimin e sendeve;

3. Zbatimin e masave policore të koordinuara të Palëve Kontraktuese në territorin e tyre për mbrojtjen ndaj rreziqeve për sigurinë dhe rendin publik, si edhe për parandalimin dhe zbulimin e veprave të dënueshme nga ana e gjykatave;

4. Dhënien e ndihmës së ndërsjellë në luftën kundër migracionit ilegal, sidomos kur ka të bëjë me nënshtetasit e Palëve Kontraktuese, si dhe ngritjen e masave të nevojshme organizative;

5. Shkëmbimin e përvojave në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore, parandalimin e krimit, si edhe metodat, mjetet dhe teknikat e aplikuara të kriminalistikës;

6. Shkëmbimin e përvojave të ekspertëve në fusha të caktuara të krimit, në mbrojtjen e dëshmitarëve, në migracionin ilegal dhe në organizimin e takimeve të ekspertëve.

2. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese bashkëpunojnë mbi bazën e kërkesave.

3. Informacionet sipas paragrafit 1, pikat 1 dhe 6, autoriteti kompetent i çdo Pale Kontraktuese

në përputhje me legjislacionin e tij kombëtar ia jep autoritetit kompetent të Palës tjetër Kontraktuese edhe pa kërkesë, nëse ekzistojnë argumentime konkrete se njohja e tyre është e nevojshme për Palën tjetër Kontraktuese për mbrojtjen ndaj rreziqeve për sigurinë dhe rendin publik ose për parandalimin dhe zbulimin e veprave të dënueshme nga ana e gjykatave. Palët Kontraktuese mbështesin njëra-tjetrën në lidhje me sa më sipër, sidomos kur në territorin e njërës prej Palëve Kontraktuese kryhet ose përgatitet një vepër penale dhe ka informacione se ekziston një lidhje me territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

4. Realizimi i bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese mund të bëhet edhe nëpërmjet oficerëve ndërlidhës. Oficeri ndërlidhës kryen veprimtari të informimit dhe të këshillimit dhe nuk ka kompetenca ekzekutive. Detyrat e oficerit ndërlidhës caktohen nga autoritetet kompetente në përputhje me legjislacionin kombëtar.

Neni 3

Mbrojtja e dëshmitarëve

1. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese mbështesin njëri-tjetrin në mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të anëtarëve të familjes së tyre (në vijim "personi që duhet të mbrohet").

2. Mbështetja përfshin veçanërisht shkëmbimin e informacioneve, ndihmën logjistike dhe marrjen nën mbrojtje të personave që duhet të mbrohen.

3. Një marrëveshje e veçantë zbatimi do të rregullojë në çdo rast të veçantë modalitetet e bashkëpunimit në marrjen nën mbrojtje të personave që duhet të mbrohen.

4. Personi që duhet të mbrohet duhet të jetë i përfshirë në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve të Palës Kontraktuese kërkuese. Personi që duhet të mbrohet nuk do të përfshihet në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve të Palës Kontraktuese të kërkuar. Në zbatimin e masave mbështetëse në lidhje me mbrojtjen e këtij personi do të aplikohet legjislacioni i Palës Kontraktuese të kërkuar.

5. Nëse është e nevojshme, Pala Kontraktuese kërkuese mbulon shpenzimet e jetesës për personat që duhet të mbrohen, si edhe shpenzimet për masat e tjera, zbatimin e të cilave kjo Palë Kontraktuese ka kërkuar. Pala kontraktuese e kërkuar mbulon shpenzimet për personelin dhe materialet e nevojshme për mbrojtjen e këtyre personave.

6. Pala Kontraktuese e kërkuar, mund të përfundojë masat mbështetëse duke parashtruar arsye të rëndësishme pas informimit të parshëm të Palës Kontraktuese kërkuese. Në raste të tilla Pala Kontraktuese kërkuese është e detyruar ta marrë përsëri përsipër personin.

Neni 4

Autoritetet kompetente

1. Për bashkëpunimin në kuptimin e kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me legjislacionin kombëtar, autoritetet kompetente janë:

1. nga Pala Shqiptare: Ministri i Brendshëm;

2. nga Pala Austriake: Ministri Federal i Punëve të Brendshme.

2. Palët Kontraktuese informojnë njëra-tjetrën mbi ndryshimet që do të ndodhin në kompetencën ose emërtimin e këtyre autoriteteve.

3. Shkëmbimi i informacioneve ndërmjet Palëve Kontraktuese në kuadrin e Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (ICPO-Interpol) mund të plotësohet në përputhje me legjislacionin kombëtar, nëpërmjet kontakteve direkte ndërmjet zyrave të specializuara.

Neni 5

Mbrojtja e të dhënave

Transmetimi i ndërsjellë i të dhënave personale (të quajtura në vazhdim: të dhënat) midis autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese bëhet në përputhje me legjislacionin kombëtar përkatës, duke respektuar kushtet e caktuara nga ana e autoritetit dërgues dhe në përputhje me parimet e mëposhtme që u aplikohen në të njëjtën masë të dhënave të përpunuara me ose pa ndihmën e kompjuterit:

1. Pa marrë paraprakisht miratimin e autoritetit dërgues nuk lejohet që të dhënat e transmetuara të përdoren për asnjë qëllim tjetër, përveç qëllimeve që qëndrojnë në thelb të transmetimit. Një miratim i tillë mund të jepet vetëm, nëse legjislacioni kombëtar i Palës Kontraktuese që disponon këto të dhëna, lejon një përdorim për qëllime të tjera.

2. Të dhënat e transmetuara duhet të fshihen ose të korrigjohen që në momentin që:

a) këto të dhëna rezultojnë të pasakta; ose

b) autoriteti dërgues informon se të dhënat e transmetuara u hetuan ose u transmetuan në mënyrë të kundërligjshme, ose disa të dhëna të transmetuara në mënyrë të ligjshme sipas legjislacionit kombëtar të autoritetit dërgues duhet të fshihen më vonë; ose

c) të dhënat nuk nevojiten më për përmbushjen e detyrës së autoriteteve për të cilën janë transmetuar, me përjashtim të rasteve kur ekziston një autorizim i shprehur qartë se të dhënat e transmetuara mund të përdoren për qëllime të tjera.

3. Në rastin e një kërkese nga ana e autoritetit kompetent dërgues të një Pale Kontraktuese, autoriteti marrës duhet të japë informacion mbi çdo përdorim të të dhënave të marra.

4. Autoriteti dërgues kompetent garanton saktësinë dhe aktualitetin e të dhënave të transmetuara. Përveç kësaj, ka për detyrë të marrë parasysh domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin lidhur me qëllimin e ndjekur për transmetimin dhe të kujdeset për respektimin e ndalimeve të transmetimit, sipas legjislacionit kombëtar përkatës. Kur del se janë transmetuar të dhëna të pasakta ose të dhëna që nuk duhej të transmetoheshin, ose duhet sipas legjislacionit të shtetit të autoritetit dërgues të fshihen më vonë disa të dhëna të transmetuara në mënyrë të ligjshme, autoriteti marrës duhet menjëherë të informohet mbi këtë. Nga ana e tij ky i fundit duhet të ndërmarrë menjëherë fshirjen ose korrigjimin e nevojshëm.

5. Nëse autoriteti marrës ka arsye të supozojë se disa të dhëna të transmetuara janë të pasakta ose duhet të fshiheshin, ai informon pa humbur kohë autoritetin dërgues rreth kësaj.

6. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese përkujdesen që për transmetimin e të dhënave të përdoren vetëm mjete të tilla komunikimi që ofrojnë një mbrojtje të përshtatshme të të dhënave kundër njohjes ose ndryshimit të paligjshëm nga të tretët gjatë procesit të transmetimit.

7. Autoriteti marrës ka për detyrë t'i mbrojë të dhënat e transmetuara në mënyrë të efektshme nga shkatërrimet e rastësishme ose të paautorizuara, humbjes së rastësishme, ndryshimit ose përcjelljes së mëtejshme të paautorizuar ose të rastësishëm, hyrjes së paautorizuar dhe publikimit të paautorizuar.

8. Autoritetet dërguese dhe marrëse janë të detyruara të dokumentojnë dërgimin, marrjen dhe asgjësimin e të dhënave. Dokumentacioni përmban arsyen e dërgimit, përmbajtjen, autoritetin dërgues dhe autoritetin marrës, momentin e transmetimit, si edhe të asgjësimit të të dhënave. Këto regjistrime duhet të mbrohen nëpërmjet masave të përshtatshme paraprake kundër përdorimit për qëllime të tjera dhe një shpërdorimi tjetër, dhe duhet të ruhen tri vjet. Pas këtij afati duhet të fshihen menjëherë. Të dhënat e dokumentacionit lejohen të përdoren për kontrollin e respektimit të dispozitave ligjore të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave.

9. Personi, të cilit i referohen të dhënat ka të drejtë të marrë, duke dëshmuar identitetin e tij dhe në bazë të një kërkese, nga autoriteti përgjegjës për përpunimin në një formë përgjithësisht të kuptueshme dhe pa vonesë të paarsyeshme informacione mbi të dhënat e transmetuara ose të përpunuara në lidhje me personin e tij në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, origjinën e tyre, marrësit e mundshëm dhe kategoritë e marrësve, qëllimin e parashikuar të përdorimit dhe bazën ligjore dhe të bëhet korrigjimi i të dhënave të pasakta dhe fshirja e të dhënave të përdorura në mënyrë të palejueshme. Përveç kësaj Palët Kontraktuese sigurojnë që i interesuari në rast të cenimit të të drejtave të tij për mbrojtjen e të dhënave, të ketë mundësi t'i drejtohet me një ankesë të efektshme një gjykate të pavarur dhe të paanshme të bazuar në ligj sipas nenit 6, paragrafi 1, të Konventës mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore (Konventa Europiane mbi të drejtat e njeriut) dhe që t'i jepet mundësia të kërkojë nëpërmjet një gjykate një shpërblim ose një formë tjetër kompensimi legal. Detajet e procedurës për realizimin e këtyre të drejtave varen nga legjislacioni kombëtar i Palës Kontraktuese tek e cila është bërë kërkesa. Palët Kontraktuese sigurojnë në këtë rast të paktën një nivel mbrojtjeje siç rezulton nga Konventa nr.108 e Këshillit të Europës mbi mbrojtjen e njeriut në përpunimin automatik të të dhënave personale, nga protokolli shtesë nga data 23 maj 2001, si edhe nga rekomandimi nr.R (87) 15 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës nga data 17 shtator 1987 për rregullimin e përdorimit të të dhënave personale nga ana e policisë, duke përfshirë edhe të dhënat që nuk përpunohen në mënyrë të automatizuar. Në rast të një kërkese për marrjen parasysh të këtyre të

drejtave, autoriteti që disponon të dhënat i jep autoritetit dërgues mundësinë të paraqesë pozicionin e tij para se të marrë një vendim mbi kërkesën.

Neni 6
Ruajtja e sekretit

Informacionet e transmetuara për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje i nënshtrohen parimisht sekretit zyrtar. Pala Kontraktuese që merr informacione sipas kësaj Marrëveshjeje siguron për këto të paktën një ruajtje sekrete të barasvlefshme me atë të Palës Kontraktuese dërguese.

Neni 7
Konsultimet

Në rast nevoje, nëpunës drejtues të autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese mund të bëjnë konsultime për të diskutuar mjete dhe rrugë për zbatimin efektiv të kësaj Marrëveshjeje, si edhe masa të mundshme për zhvillimin e mëtejshëm dhe përmirësimin e bashkëpunimit.

Neni 8
Rregullimi i përjashtimeve

1. Nëse një Palë Kontraktuese është e mendimit se përmbushja e një kërkese ose një lloj tjetër bashkëpunimi mund të cenonte sovranitetin e saj, sigurinë e saj, rendin e saj publik ose interesa të tjera thelbësore të vendit të saj, ose mund të shkelte parime të legjislacionit të saj kombëtar, ajo mund të refuzojë plotësisht ose pjesërisht mbështetjen e saj, ose ta lidhë me plotësimin e disa kushteve.
2. Pala Kontraktuese që ka bërë kërkesën duhet të informohet mbi vendimin duke i dhënë arsyet.

Neni 9
Shpenzimet

Përsa nuk caktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, çdo Palë Kontraktuese mbulon vetë shpenzimet që i rezultojnë nga aplikimi i kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10
Raporti me rregullimet e tjera

Nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk preken të drejtat dhe detyrimet e Palëve Kontraktuese nga marrëveshjet ndërkombëtare.

Neni 11
Interpretimi i Marrëveshjes

1. Mosmarrëveshjet mbi interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhen nëpërmjet negociatave direkte midis autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese.
2. Nëse nuk arrihet një zgjidhje nëpërmjet negociatave sipas paragrafit 1, çështja do të zgjidhet në rrugë diplomatike.

Neni 12
Mbarimi i vlefshmërisë së një marrëveshjeje të mëparshme

Me datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje shfuqizohet marrëveshja midis Ministrisë së Rendit Publik të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrit Federal për Punë të Brendshme të Republikës së Austrisë mbi bashkëpunimin në luftën ndaj krimit të organizuar ndërkombëtar dhe të tregtimit ilegal ndërkombëtar të drogave narkotike nga data 12 dhjetor, 1996.

Neni 13

Hyrja në fuqi dhe denoncimi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të tretë pas momentit kur Palët Kontraktuese informojnë njëra-tjetrën mbi plotësimin e procedurave të brendshme ligjore përkatëse të nevojshme për këtë.

2. Kjo Marrëveshje lidhet nga të dyja Palët për një kohëzgjatje të pacaktuar. Me mirëkuptim të dyanshëm mund të bëhen në çdo kohë ndryshime të kësaj Marrëveshjeje.

3. Kjo Marrëveshje mund të denoncohet nga Palët Kontraktuese në rrugë diplomatike. Denoncimi hyn në fuqi tre muaj pas marrjes së njoftimit nga Pala tjetër Kontraktuese.

Bërë në Tiranë, më 29 qershor 2007 në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe gjermane, ku të dy tekstet janë autentikë.

LIGJ
Nr.9812, datë 1.10.2007

PËR MIRATIMIN E "MARRËVESHJES MINERARE TË SHFRYTËZIMIT NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË "CEMENTOS AGUILA" SHPK"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet "Marrëveshja minerare e shfrytëzimit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Shoqërisë "Cementos Aguila" sh.p.k.", miratuar me vendimin nr.515, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5489, datë 10.10.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE MINERARE E SHFRYTËZIMIT

E lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e përfaqësuar nga Kristo Rodi, Drejtor i Përgjithshëm, i autorizuar nga Ministri z.Genc Ruli dhe

"Cementos Aguila" sh.p.k. shoqëri e themeluar në bazë të legjislacionit shqiptar me vendim nr.36422, datë 3.10.2006, me seli në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Twin Towers (Kullat binjake), nr.2, kati 11/3, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga administratori i shoqërisë z.Emilio Izquierdo Merlo.

Duke pasur parasysh që:

- Në kuadrin e zhvillimit ekonomik të vendit, Qeveria Shqiptare i ka dhënë prioritet zhvillimit të zonave industriale lidhur me aktivitetin minerar;
- Legjislacioni në fuqi, rregullon aktivitetet minerare dhe marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe

personave juridikë që synojnë të përfitojnë nga legjislacioni minerar. Të gjitha të drejtat minerare të siguruara në përputhje me ligjin "Ligji minerar i Shqipërisë" nr.7796, datë 17.2.1994, të ndryshuar, dhe ushtrimi i çdo aktiviteti minerar në Shqipëri bazohen në legjislacionin shqiptar dhe do të ushtrohen në përputhje me të;

- Qeveria e Shqipërisë mirëpret investitorët vendas dhe të huaj për shfrytëzimin e çdo vendburimi minerar, me qëllim nxjerrjen e mineraleve duke përfshirë kërkimin, shfrytëzimin dhe zbulimin brenda një depozite minerare;

- Qeveria e Shqipërisë është deklaruar për një politikë të tërheqjes dhe mbështetjes së investimeve të huaja. Në zbatim të këtyre politikave ajo është e angazhuar t'i inkurajojë dhe mbështesë ata sa më gjerësisht që të jetë e mundur nëpërmjet sigurimit të bashkëpunimit të gjitha autoriteteve shtetërore apo institucioneve të tjera nën kontrollin e saj, veçanërisht që të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre duke iu përgjigjur brenda një kohe sa më të shkurtër kërkesave të personave juridikë sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë. Ajo angazhohet që të bëjë të mundur që këto organe shtetërore dhe institucione të tjera të mos vonojnë në mënyrë të paarsyeshme aprovimin e tyre, për të siguruar zhvillimin e infrastrukturës së duhur nga Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit për të mundësuar investimin për ngritjen dhe vënien në funksionim të një fabrike për prodhimin e çimentos;

- Qeveria e Shqipërisë njeh si të vlefshme lejen minerare, e cila jepet nga Ministri që mbulon veprimtarinë minerare duke bërë të mundur zhvillimin e aktivitetit minerar që lidhet me kërkimin, zbulimin dhe shfrytëzimin e mineraleve;

- "Ligji minerar i Shqipërisë" nr.7796, datë 17.2.1994, i ndryshuar përcakton marrëdhënien ndërmjet shtetit shqiptar dhe personave juridikë që synojnë të përfitojnë të drejta në bazë të dispozitave të tij dhe të kryejnë aktivitete minerare;

- Ministri është i autorizuar të negociojë për nënshkrimin e një marrëveshjeje lehtësuese për investime lartpërmendur me Zotëruesin e lejes minerare, marrëveshje e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe në vijim nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Ministri negocion Marrëveshjen me Zotëruesin e lejes minerare.

Zotëruesi i lejes minerare:

- Është seriozisht i interesuar të ushtrojë aktivitetin minerar dhe për përdorimin **e** produkteve minerare për qëllime industriale si lëndë të para për prodhimin e çimentos;

- Ka ndërmarrë studimin tekniko-ekonomik për shfrytëzimin e mineraleve të grupit të katërt (siç përcaktohet në ligjin minerar sipërpërmendur), dhe ndërtimin e fabrikës për prodhimin e çimentos për qëllime industriale;

- Në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të ndërmarrë ndërtimin dhe vënien në funksionim të fabrikës për prodhimin e çimentos dhe zhvillimin e infrastrukturës lidhur me të, duke investuar një shumë prej rreth 155 459 000.00 euro (njëqind e pesëdhjetë e pesë milionë e katërqind e pesëdhjetë e nëntë mijë).

Palët:

Bien dakord që të bashkëpunojnë për shfrytëzimin e materialeve ndërtimore (gurit gëlqeror) në zonën gëlqerore Drojë-Mamurras, në përputhje me lejet minerare me të cilat është pajisur shoqëria e sipërpërmendur zotëruese e lejes minerare dhe sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 1

Përkufizime

Kudo ku janë përdorur termat e mëposhtme në këtë Marrëveshje, respektivisht ato do të kenë kuptimet si vijon:

- Marrëveshje minerare e shfrytëzimit: Kjo Marrëveshje me të gjitha përkufizimet;

- Zotëruesi i lejes minerare: Shoqëria "Cementos Aguila" sh.p.k.;

- Periudha e shfrytëzimit minerar: Periudha kohore e shfrytëzimit të mineraleve në zonën minerare për 99 vjet;

- Zona minerare: Sipërfaqja e kërkuar nga Zotëruesi i lejes minerare për shfrytëzimin e mineraleve të grupit të katërt, në zonën gëlqerore Droje-Mamurras, siç përcaktohet në lejen e shfrytëzimit minerar nr.1048, datë 31.7.2007. Koordinatat që përcaktojnë sipërfaqen e zonës minerare jepen në aneksin nr.1, bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje.

- Projekt: Studimi tekniko-ekonomik për shfrytëzimin minerar.

Neni 2
Objekti i Marrëveshjes

Objekti i kësaj Marrëveshjeje do të jetë dhënia Zotëruesit e të drejtës për të ushtruar aktivitet minerar në zonën minerare gjatë periudhës së shfrytëzimit minerar dhe gjithashtu përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të Palëve për përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 3
Kritere specifike të punimeve

Plani i investimit do të zbatohet nga Zotëruesi i lejes minerare për një kohëzgjatje maksimale prej 4 (katër) vitesh, të cilat do të ndahen në 3 (tre) faza, plus një fazë të tretë të mirëmbajtjes deri në fund të periudhës së shfrytëzimit minerar.

Faza e parë

Punimet përgatitore për hapjen e karrierave të gëlqerorit në gëlqerore Droje-Mamurras do të kryhen gjatë një periudhe prej katër (4) vitesh.

Faza e Pare A): Studimet teknike të karrierave, studimet gjeologjike dhe gjeoteknike, shpimet dhe analizat e mineraleve me një investim të përafërt gjatë vitit të parë prej 500 000 euro (pesëqind mijë).

Studimet teknike, projektimi dhe punimet përgatitore (shpimet gjeologjike dhe gjeoteknike, rrugët e hyrjes etj.) për hapjen e karrierave dhe ndërtimin e fabrikës për prodhimin e çimentos kanë filluar. Faza e Parë B) Blerja, montimi dhe fillimi i punës së impianitit të thyerjes që ndodhet në karrier. Makineritë e lëvizshme.

Vlera e përafërt e investimit në vitin e tretë: 800 000 euro (tetëqind mijë) dhe në vitin e katërt: 7 200 000 euro (shtatë milionë e dyqind mijë), specifikuar sipas tabelës së mëposhtme:

Viti	**Aktiviteti**	**Vlera e investimit në milion EURO**
2007	Studimet teknike të karrierave, studimet gjeologjike dhe gjeoteknike, shpimet dhe analizat e mineraleve	0.50
2009	Punimet në karriera për impianitin e thyerjes	0.80
2010	Pajisjet fikse, montimi dhe fillimi i punës. Pajisje të lëvizshme	7.20

Faza e dytë

Ndërtimi i fabrikës për prodhimin e çimentos do të bëhet paralelisht me fazën e parë dhe gjatë një periudhe totale prej 4 vitesh, me një investim total prej rreth 146 950 000 euro (njëqind e dyzet e gjashtë milionë e nëntëqind e pesëdhjetë mijë).

Investimet që lidhen me karrierat do të kryhen paralelisht dhe do të përfundojnë jo më vonë se përfundimi i fabrikës për prodhimin e çimentos.

Investimet gjatë kësaj faze të dytë do të ndjekin radhën e treguar në tabelën në vijim:

Viti	**Aktiviteti**	**Vlera në milion EURO**
2007	Mbyllja **e** marrëveshjes për ndërtimin e fabrikës së prodhimit të çimentos, pagesa për kontraktorin (10%); Mbyllja e projektit të rrugëve ndërmjet karrierave dhe fabrikës, si dhe midis fabrikës dhe autostradës, paraqitja e dokumenteve dhe marrja e lejes; Punimet për kampin e punëtorëve të huaj. Fillimi i punimeve për fjetoret (shtëpitë).	6.89
2008	Pagesa për kontraktorin (20%); Punime dherash për fabrikën, fillimi i punimeve për rrugët e brendshme;	28,91

	Ndërtimi i themeleve. Punime të tjera; Instalimi i 50% të transformatorëve dhe rrjetit elektrik të tensionit të lartë; Ndërtimi i disa strukturave, mbarimi i konstruksionit të fabrikës dhe shpimi për ujë; Punime të tjera.	
2009	Punime dherash dhe punime përgatitore në karrierë për impianitin e thyerjes; Pagesa për kontraktorin (40%); Punime përgatitore dhe struktura; Fillimi i punimeve për rrugët e jashtme; Disenjimi i ndërtesave joprodhuese, aplikimi të autoritetet për marrjen e lejes. Fillimi i punimeve për ndërtimin e ndërtesave në fjalë 50% e transformatorëve dhe rrjetit elektrik të tensionit të lartë; Konstruksione; Punime të tjera.	57,96
2010	Përfundimi i punimeve për ndërtesat prej betoni dhe i ngritjes së strukturave të çelikut dhe pajisjeve; Pagesa e fundit për kontraktorin (3 0%); Mbarimi i ndërtimit të rrugëve të jashtme; Instalimet elektrike, elektronike dhe lidhja; Mbarimi i ndërtimit të disa ndërtesave joprodhuese; Testi pa ngarkesë dhe i prodhimit; Fillimi i prodhimit; Çmobilizimi i kampit të punëtorëve të huaj; Të tjera.	53,18

Faza e tretë

Punimet për mirëmbajtjen dhe investimet për rrugët e brendshme të karrierave të gëlqerorit të gëlqerore Droje-Mamurras do të bëhen gjatë periudhës së mbetur deri në fund të shfrytëzimit minerar sipas nevojës.

Vlera e mirëmbajtjes dhe investimeve gjatë kësaj faze të tretë llogaritet mbi shumën prej 3 000 000 në vit gjatë gjithë ekzistencës së aseteve.

Bilancet vjetore do të përdoren si dokumente për monitorimin e investimit.

Neni 4

Fillimi i ndërtimit

Zotëruesi i lejes minerare duhet të fillojë ndërtimin e fabrikës për prodhimin e çimentos brenda 7 muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Një fillim i tillë do të kushtëzohet nga disponueshmëria e tokës për qëllimet e ndërtimit të fabrikës për kohëzgjatjen e kësaj lejeje minerare të zgjatur, si dhe dhënien e të gjitha lejeve dhe licencave të nevojshme për ndërtimin e fabrikës për prodhimin e çimentos nga të gjitha autoritetet kompetente.

Neni 5

Detyrimet dhe të drejtat e Zotëruesit të lejes minerare

Zotëruesi i lejes minerare është i detyruar:

- Të zbatojë punimet për shfrytëzimin e karrierave në përputhje me projektin e investimit, sipas dispozitave të nenit 3, nëse autoritetet shtetërore kompetente nuk e kanë refuzuar padrejtësisht dhënien e të gjitha licencave dhe lejeve të nevojshme si për karrierat, ashtu edhe për fabrikën për prodhimin e çimentos.
- Të sigurojë ecurinë normale dhe drejtimin e punimeve, ndërsa do të mbajë Ministrinë vazhdimisht të informuar, përsa i përket procesit minerar, në përputhje me kërkesat e legjislacionit

minerar në fuqi.

- Të paguajë të gjitha detyrimet fiskale, taksat dhe pagesat e tjera që burojnë nga zbatimi i këtij aktiviteti ekonomik, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

- Të zbatojë të gjitha aktet ligjore dhe normative në fuqi për mbrojtjen e ambientit në Republikën e Shqipërisë.

Zotëruesi i lejes minerare ka të drejtë:

Në përputhje me nenin 69 të ligjit nr.7796, datë 17.2.1994, i ndryshuar, palët me qëllim që të sigurojnë një zhvillim të mirëbalancuar të aktivitetit minerar të shfrytëzimit në Shqipëri (hapjen e një karriere për materiale ndërtimi) dhe mbrojtjen në mënyrë të përshtatshme të investimit të Zotëruesit të lejes minerare dhe aktivitetin e Zotëruesit të lejes minerare në kuadër të investimit për ndërtimin dhe vënien në funksionim të një fabrike për prodhimin e çimentos, bien dakord që Zotëruesi i lejes minerare për një periudhë prej 99 vitesh nga firmosja e kësaj Marrëveshjeje dhe aprovimi i saj nga Kuvendi i Shqipërisë do të ketë të drejtën ekskluzive të ushtrojë këtë aktivitet shfrytëzimi minerar në zonën minerare, sipas përcaktimeve të mësipërme.

Neni 6

Të drejtat dhe detyrimet e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

- Ministria garanton se ajo ka kompetenca dhe autoritet ligjor të plotë për të firmosur këtë Marrëveshje;

- Ministria garanton përdorim të pacenuar dhe të papenguar të sipërfaqeve të tokës, objekt i kësaj Marrëveshjeje, për periudhën e vlefshmërisë së kësaj Marrëveshjeje.

- Ministria garanton që sipërfaqet e karrierave do të jenë të lira nga pretendime të palëve të treta për ndonjë peng, pengesë apo barrë të çfarëdolloji, bazuar në shkresën nr.371, prot., datë 3.8.2007 të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kurbin. Ministria merr përsipër që të ndihmojë Zotëruesin e lejes minerare për marrjen në rrugë ligjore të të gjitha lejeve dhe licencave për ndërtimin dhe vënien në funksionim të fabrikës për prodhimin e çimentos dhe të lidhjes rrugore të saj me karrierat dhe tregun, nga autoritetet shtetërore apo institucione të tjera nën kontrollin e tyre të drejtpërdrejtë dhe të ndihmojë që këto leje të jepen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 7

Kohëzgjatja e shfrytëzimit minerar

Ministria i garanton Zotëruesit të lejes minerare të drejtën e shfrytëzimit të mineraleve në zonën minerare për një kohëzgjatje prej 99 vitesh. Kjo periudhë kohore do të fillojë nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe aprovimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Neni 8

Programi i punimeve

Zotëruesi i lejes minerare garanton se do të kryejë investimet e parashikuara në planin e ndërtimit dhe të shfrytëzimit, me qëllim realizimin e objektit të kësaj Marrëveshjeje. Projekti do të zbatohet sipas nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje dhe sipas planit përkatës të investimit të paraqitur.

Neni 9

Përfundimi i Marrëveshjes së shfrytëzimit minerar

Ministria mund të zgjidhë këtë Marrëveshje kur ajo gjykon se kanë ndodhur shkelje të vazhdueshme të detyrimeve të ndërmarra nga Zotëruesi i lejes minerare, të tilla që mund të bëjnë të pamundur vijimin e punimeve sipas parashikimit në planin e shfrytëzimit minerar.

Kur vihen re shkelje, Ministria duhet të njoftojë Zotëruesin e lejes minerare rreth këtyre shkeljeve dhe të presë 30 ditë për një përgjigje shpjeguese.

Mosplotësimi i ndonjërit nga detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje nuk duhet të konsiderohet që është një shkelje e kësaj Marrëveshjeje përsa kohë që kjo mospërmbushje vjen si pasojë e një ngjarjeje që konsiderohet si forcë madhore, dhe kur është provuar se Pala e prekur nga kjo ngjarje (a)

ka marrë të gjitha masat parandaluese të arsyeshme, si dhe të gjitha hapat e nevojshme për të zbatuar termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje; dhe (b) ka informuar menjëherë Palën tjetër për ndodhinë e kësaj ngjarjeje.

"Një ngjarje forcë madhore" do të thotë çdo ngjarje ose rrethanë apo kombinim i tyre që pengon plotësisht apo pjesërisht secilën nga Palët për plotësimin e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje, vetëm nëse dhe në atë masë që një ngjarje apo rrethanë e tillë është përtej kontrollit të arsyeshëm direkt apo indirekt të Palës së prekur, dhe nuk mund të ishte parandaluar nga çfarëdo masë e arsyeshme që kjo Palë mund të kishte ndërmarrë.

Ngjarja forcë madhore përfshin ngjarjet në vijim, por pa u kufizuar vetëm me to, me kusht që ato të plotësojnë termat e sipërpërmendura:

i) çdo akt lufte (i deklaruar apo jo), luftë civile, pushtim, konflikt i armatosur apo veprim i armikut të jashtëm, kryengritje apo terrorizëm që përfshijnë apo ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në Republikën e Shqipërisë;

ii) Revolucion, protesta, rebelim ose çdo lloj revolte civile, akte terrorizmi apo sabotazhi, të cilat në çdo rast përfshijnë apo ndikojnë direkt Republikën e Shqipërisë;

iii) Greva të shpërndara gjerësisht dhe/ose në shkallë, politike, kombëtare;

iv) Kontaminim bërthamor, kimik ose biologjik, të cilat direkt apo indirekt ndikojnë sipërfaqen objekt të kësaj Marrëveshjeje, përveç rasteve kur shkaku i këtij kontaminimi vjen si rezultat i veprimeve të shoqërisë ose kontraktorëve të saj;

v) Epidemitë ose infeksionet, të cilat direkt ose indirekt ndikojnë në zonën e koncesionit.

Në raste vonesash të shkaktuara nga Ministria ose nga ndonjë organ tjetër shtetëror, i cili kryen funksionet e tij në lidhje të drejtpërdrejtë me lëshimin e licencave dhe lejeve të tjera ndërtimore të nevojshme për ndërtimin dhe vënien në funksionim të fabrikës për prodhimin e çimentos ose vonesa të pajustifikuara të shkaktuara nga organe të tjera qeveritare gjatë kryerjes së funksioneve që lidhen me këtë Marrëveshje dhe nuk janë nën kontrollin e shoqërisë, periudha e vonesës nuk do të llogaritet në kuadrin e afateve kohore të vendosura me sipër.

Në rastet e forcës madhore, afatet kohore të përmendura në nenin 3 të mësipërm për Zotëruesin e lejes minerare do të shtyhen në përputhje me të, por në asnjë rast kjo nuk do të ndikojë në zgjatjen e periudhës së shfrytëzimit minerar, e cila mund të shtyhet vetëm sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Neni 10
Kontrolli dhe investimi

Ministria ka të drejtën dhe detyrimin që të kontrollojë rregullisht zbatimin **e** Marrëveshjes sipas kushteve të parashikuara në të dhe në përputhje me detyrimet e saj që rrjedhin nga "Ligji minerar i Shqipërisë" nr.7796, datë 17.2.1994.

Ministria dhe Zotëruesi i lejes minerare do të përcaktojnë së bashku mënyrën me të mirë të kontrollit, duke siguruar në të gjitha rastet që ky aktivitet nuk do të paraqesë ndërhyrje të paarsyeshme në zbatimin e projektit. Zotëruesi i lejes minerare do të japë çdo shpjegim teknik që kërkohet.

Zotëruesi i lejes minerare do të vërë në dispozicion të Ministrisë pasqyrat financiare vjetore të tij, të hartuara në përputhje me standardet e kontabilitetit, me qëllim verifikimin e zbatimit të investimit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Në çdo rast kur Ministria identifikon shkelje, ajo do t'ia komunikojë me shkrim, në mënyrë mjaft të hollësishme, vërejtjet dhe gjetjet e saj Zotëruesit të lejes minerare, me kërkesën që punimet duhet të vazhdohen sipas përcaktimeve të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11
Ligji i aplikueshëm

Kjo Marrëveshje rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi. Ministria garanton se të drejtat e Zotëruesit të lejes minerare sipas kësaj Marrëveshjeje, që lidhen me shfrytëzimin e karrierave për një periudhë prej 99 vitesh dhe përdorimi i tokës për një periudhë prej 99 vitesh do të zgjasë dhe do të vijojnë të qëndrojnë në fuqi, pavarësisht çdo ndryshimi të dispozitave ligjore që lidhen me to, të aplikueshme në Shqipëri që do të hyjnë në fuqi pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rastin e ndonjë mosmarrëveshjeje, e cila mund të lindë nga dhe në lidhje me këtë Marrëveshje gjatë zbatimit të saj, e cila nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim reciprok ndërmjet palëve do të zgjidhet përfundimisht nëpërmjet arbitrazhit ndërkombëtar, në përputhje me rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), nga një apo tre arbitra, që do të emërohen sipas rregullave të sipërpërmendura.

Vendi i arbitrazhit do të jetë në Paris, Francë dhe gjuha e arbitrazhit do të jetë anglishtja.

Neni 13
Bashkëpunimi

Ministria dhe Zotëruesi i lejes minerare bien dakord që të bashkëpunojnë, me qëllimin për të garantuar zbatimin e projektit siç është përcaktuar në këtë Marrëveshje.

Njoftimet dhe komunikimet e tjera ndërmjet Palëve duhet të dërgohen në adresat respektive të Palëve.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas firmosjes së saj nga Palët, dhe pasi ajo të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe më pas të miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr.7796, datë 17.2.1994, i ndryshuar.

Për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e përfaqësuar me autorizimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga
Kristo Rodi
Drejtor i Përgjithshëm

Për shoqërinë "Cementos Aguila" sh.p.k.

Përfaqësuar nga administratori i shoqërisë
Emilio Izquierdo Merl
Administrator

ANEKSI NR.I

Koordinatat e zonës së shfrytëzimit dhënë me lejen minerare nr.1048, datë 31.7.2007

Nr	Y	X
1	43 92 632	46 02 900
2	43 92 632	46 03 120
3	4392785	4603120
4	4392785	4603105
5	4392835	4603105
6	4392835	4603155
7	4392785	4603155
8	4392785	4603140
9	4392632	4603140
10	4392632	4603470
11	4392525	4603675

12	4392200	4603750
13	43 92 170	46 03 850
14	4392000	4603870
15	4391 800	4604000
16	4391800	4604400
17	4391880	4604450
18	4391 920	4604425
19	4392065	4604425
20	4392065	4604500
21	4392050	4604500
22	43 92 050	46 04 600
23	4392250	4604800
24	43 92 350	46 04 800
25	43 92 475	46 04 700
26	4392575	4604675
27	43 92 600	46 04 700
28	43 92 600	46 04 750
29	43 92 690	46 04 775
30	43 92 800	46 04 780
31	4392810	4604585
32	43 92 750	46 04 575
33	43 92 725	46 04 500
34	43 92 750	4604 475
35	43 92 830	46 04 490
36	43 92 850	46 04 350
37	43 92 700	46 04 000
38	43 92 600	46 03 900
39	43 92 550	46 03 850
40	43 92 525	46 03 700
41	43 92 650	4603475
42	43 92 800	4603 500
43	43 93 040	46 03 450
44	43 93 040	46 02 900

LIGJ
Nr.9813, datë 1.10.2007

PËR MIRATIMIN E "MARRËVESHJES MINERARE TË SHFRYTËZIMIT NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË "ANTEA CEMENT" SHA"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet “Marrëveshja minerare e shfrytëzimit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Shoqërisë “Antea Cement” sha”, miratuar me vendimin nr.519, datë 25.7.2007 të Këshillit të Ministrave.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5490, datë 10.10.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE MINERARE E SHFRYTËZIMIT

E lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e përfaqësuar nga Ministri, z.Genc Ruli dhe

Antea Cement SHA, shoqëri e themeluar në bazë të legjislacionit shqiptar me vendimin nr.36120, datë 7.7.2006, me seli në Rr. “Luigj Gurakuqi”, pallati 89, seksioni A, kati 10, Tiranë, e përfaqësuar ligjërisht për negociimin dhe nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje nga z.Eleftherios Gkaris, Drejtor i Përgjithshëm,

duke pasur parasysh që:

- Në kuadrin e zhvillimit ekonomik të vendit, Qeveria Shqiptare i ka dhënë prioritet zhvillimit të zonave industriale lidhur me aktivitetin minerar;

- Legjislacioni në fuqi, rregullon aktivitetet minerare dhe marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe personave juridikë që synojnë të përfitojnë nga legjislacioni minerar. Të gjitha të drejtat minerare të siguruara në përputhje me ligjin “Ligji minerar i Shqipërisë” nr.7796, datë 17.2.1994, të ndryshuar,dhe ushtrimi i çdo aktiviteti minerar në Shqipëri bazohen në legjislacionin shqiptar dhe do të ushtrohen në përputhje me të;

- Qeveria e Shqipërisë mirëpret investitorët vendas dhe të huaj për shfrytëzimin e çdo vendburimi minerar, me çfarëdolloj mënyre, me qëllim nxjerrjen e mineraleve duke përfshirë kërkimin, shfrytëzimin dhe zbulimin brenda një trupi minerar;

- Qeveria e Shqipërisë është deklaruar për një politikë të tërheqjes dhe të mbështetjes së investimeve të huaja. Në zbatim të këtyre politikave ajo është e angazhuar t’i inkurajojë dhe mbështesë ata sa më gjerësisht që të jetë e mundur nëpërmjet sigurimit të bashkëpunimit të të gjitha autoriteteve shtetërore apo institucioneve të tjera nën kontrollin e saj, veçanërisht që të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre duke iu përgjigjur brenda një kohe sa më të shkurtër kërkesave të personave juridikë sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Ajo angazhohet që të bëjë të mundur që këto organe shtetërore dhe institucione të tjera të mos vonojnë në mënyrë të paarsyeshme aprovimin e tyre, për të siguruar zhvillimin e infrastrukturës së duhur nga Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit, për të mundësuar investimin për ngritjen dhe vënien në funksionim të një fabrike për prodhimin e çimentos;

- Qeveria e Shqipërisë njeh si të vlefshme lejen minerare, e cila jepet nga Ministri që mbulon veprimtarinë minerare duke bërë të mundur zhvillimin e aktivitetit minerar që lidhet me kërkimin, zbulimin dhe shfrytëzimin e mineraleve;

- “Ligji minerar i Shqipërisë” nr.7796, datë 17.2.1994, i ndryshuar, përcakton marrëdhënien ndërmjet shtetit shqiptar dhe personave juridikë që synojnë të përfitojnë të drejta në bazë të dispozitave të tij dhe të kryejnë aktivitete minerare;

- Ministri është i autorizuar të negociojë për nënshkrimin e një marrëveshjeje lehtësuese për investimin e lartpërmendur me Zotëruesin e lejes minerare, Marrëveshje, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe në vijim nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Ministri negocion Marrëveshjen me Zotëruesin e lejes minerare.

Zotëruesi i lejes minerare:

- Është seriozisht i interesuar të ushtrojë aktivitetin minerar dhe për përdorimin e produkteve minerale për qëllime industriale si lëndë të para për prodhimin e çimentos;

- Ka ndërmarrë studimin tekniko-ekonomik për shfrytëzimin e mineraleve të grupit të katërt (siç përcaktohet në ligjin minerar të sipërpërmendur), dhe ndërtimin e fabrikës për prodhimin e

çimentos për qëllime industriale;

- Në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të ndërmarrë ndërtimin dhe vënien në funksionim të fabrikës për prodhimin e çimentos dhe zhvillimin e infrastrukturës së lidhur me të, duke investuar një shumë prej rreth 200 milionë dollarë amerikanë.

Palët:

Bien dakord që të bashkëpunojnë për shfrytëzimin e materialeve ndërtimore (gëlqeror dhe argjila) në zonën e Borizanës, në përputhje me lejet minerare të shfrytëzimit me të cilat është pajisur shoqëria e sipërpërmendur, Zotëruese e lejes minerare dhe sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 1
Përkufizime

Kudo ku janë përdorur termat e mëposhtme në këtë Marrëveshje, respektivisht ato do të kenë kuptimet si vijon:

- Marrëveshje minerare e shfrytëzimit: Kjo Marrëveshje me të gjitha shtojcat që përbën pjesën integrale të saj;
- Zotëruesi i lejes minerare: Shoqëria "Antea Cement" sh.a. Tiranë;
- Periudha e shfrytëzimit minerar: Periudha kohore e shfrytëzimit të mineraleve në zonën minerare për 99 vjet;
- Zona minerare: Sipërfaqet e kërkuara nga Zotëruesi i lejes minerare për shfrytëzimin e mineraleve të grupit të katërt, në zonën e Borizanës, siç përcaktohet në aneksin 1;
- Projekt: Studimi tekniko-ekonomik për shfrytëzimin minerar.

Neni 2
Objekti i Marrëveshjes

Objekti i kësaj Marrëveshjeje do të jetë dhënia Zotëruesit e të drejtës për të ushtruar aktivitet minerar në zonën minerare gjatë periudhës së shfrytëzimit minerar dhe, gjithashtu përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të Palëve për përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 3
Kritere specifike të punimeve

Plani i investimit do të zbatohet nga Zotëruesi i lejes minerare për një kohëzgjatje maksimale prej 4 (katër) vitesh, të cilat do të ndahen në 2 (dy) faza, plus dhe një fazë të tretë të mirëmbajtjes deri në fund të periudhës së shfrytëzimit minerar.

Faza e parë

Punimet përgatitore për hapjen e karrierave të gëlqerorit dhe flish/argjilave në Borizanë do të kryhen gjatë një periudhe prej 3 vitesh, me investime në vitin e parë prej rreth 300 000 $, në vitin e dytë 150 000 $ dhe në vitin e tretë 100 000 $. Studimet teknike, projektimi dhe punimet përgatitore (shpimet gjeologjike dhe gjeoteknike, rrugët e hyrjes etj.) për hapjen e karrierave dhe ndërtimin e fabrikës për prodhimin e çimentos kanë filluar aktualisht dhe pritet që të përfundojnë brenda një viti pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Faza e dytë

Ndërtimi i fabrikës për prodhimin e çimentos do të bëhet paralelisht me fazën e parë dhe gjatë një periudhe totale prej 4 vitesh, me një investim total prej rreth 200 milionë $, duke përfshirë edhe vlerën e pajisjeve dhe makinerive punuese në karriera.

Investimet që lidhen me karrierat do të kryhen paralelisht dhe do të përfundojnë jo më vonë se përfundimi i fabrikës për prodhimin e çimentos.

Investimet gjatë kësaj faze të dytë do të ndjekin radhën e treguar në tabelën në vijim:

Viti	**Aktivitetet**	**Shuma në milionë dollarë**

		amerikanë
2007	Përfundimi i Marrëveshjes për ndërtimin me çelsa në dorë të fabrikës për prodhimin e çimentos, parapagimi i kontraktorit. Përfundimi i projektit të rrugëve që lidhin karrierat me fabrikën dhe fabrikën me autostradën, dorëzimi i kërkesës për lejet përkatëse dhe dhënia e lejeve. Projektimi i pjesës më të madhe të strukturave (prej betoni dhe çeliku) dorëzimi i kërkesës për lejet përkatëse tek autoritetet dhe dhënia e lejeve. Shpimet për ujë.	20
2008	Përfundimi i projektimit të strukturave (prej betoni dhe çeliku), dorëzimi tek autoritetet i kërkesës për lejet përkatëse dhe dhënia e lejeve. Punime dherash në zonën e fabrikës ndërtimi i rrugëve, punime dherash paraprake për zhvillimin e karrierave. Mobilizimi i kampit për punëtorët e huaj. Ndërtimi i sistemit të rrugëve të brendshme, ndërtimi i disa bazamenteve betoni dhe montimi i 20 % të strukturës prej çeliku.	40
2009	Projektimi i ndërtesave joprodhuese, dorëzimi i kërkesës për lejet përkatëse tek autoritete dhe dhënia e lejeve. Ndërtimi i strukturave prej betoni dhe montimi i disa strukturave prej çeliku dhe pajisjeve.	60
2010	Përfundimi i ndërtimit të strukturave prej betoni dhe montimi i strukturave prej çeliku dhe pajisjeve. Instalimi elektrik, elektronik dhe lidhjet. Ndërtimi i disa ndërtesave joprodhuese.	40
2011	Përfundimi i ndërtesave joprodhuese. Përfundimi i të gjitha instalimeve. Prova në boshllëk dhe teste prodhimi. Fillimi i prodhimit. Çmobilizimi i kampit të punëtorëve të huaj.	40

Faza e tretë

Punimet për mirëmbajtjen dhe investimet për rrugët e brendshme të karrierave të gëlqerorit dhe flish/argjilave të Borizanës do të bëhen gjatë periudhës së mbetur deri në fund të shfrytëzimit minerar sipas nevojës.

Vlera e mirëmbajtjes dhe investimeve gjatë kësaj faze të tretë llogaritet mbi shumën prej 200 milionë dollarë amerikanë që i referohet ndërtimit të fabrikës për prodhimin e çimentos.

Bilancet vjetore do të përdoren si dokumente bazë për monitorimin e investimit.

Neni 4

Fillimi i ndërtimit

Zotëruesi i lejes minerare duhet të fillojë ndërtimin e fabrikës për prodhimin e çimentos brenda 9 muajsh pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Një fillim i tillë do të kushtëzohet nga disponueshmëria e tokës për qëllimet e ndërtimit të fabrikës për kohëzgjatjen e këtij koncesioni minerar të zgjatur, si dhe dhënien e të gjitha lejeve dhe licencave të nevojshme për ndërtimin e fabrikës për prodhimin e çimentos nga të gjitha autoritetet kompetente.

Neni 5

Detyrimet dhe të drejtat e Zotëruesit të lejes minerare

Zotëruesi i lejes minerare është i detyruar:

- Të zbatojë punimet për shfrytëzimin e karrierave, në përputhje me projektin e investimit, sipas dispozitave të nenit 3, nëse autoritetet shtetërore kompetente nuk e kanë refuzuar padrejtësisht dhënien e të gjitha licencave dhe lejeve të nevojshme si për karrierat, ashtu edhe për fabrikën për prodhimin e çimentos;
- Të sigurojë ecurinë normale dhe drejtimin e punimeve, ndërsa do të mbajë Ministrinë vazhdimisht të informuar përsa i përket procesit minerar, në përputhje me kërkesat e legjislacionit minerar në fuqi.

Zotëruesi i lejes minerare ka të drejtë:

Në përputhje me nenin 69 të ligjit nr.7796, datë 17.2.1994, i ndryshuar, Palët me qëllim që të sigurojnë një zhvillim të mirëbalancuar të aktivitetit minerar të shfrytëzimit në Shqipëri (hapjen e një karriere për minerale apo materiale ndërtimi) dhe mbrojtjen në mënyrë të përshtatshme të investimit të Zotëruesit të lejes minerare dhe aktivitetin e Zotëruesit të lejes minerare në kuadër të investimit për ndërtimin dhe vënien në funksionim të një fabrike për prodhimin e çimentos, bien dakord që Zotëruesi i lejes minerare për një periudhë prej 99 vitesh pas firmosjes së kësaj Marrëveshjeje dhe aprovimit të saj nga Kuvendi i Shqipërisë, do të ketë të drejtën ekskluzive të ushtrojë këtë aktivitet shfrytëzimi minerar në zonën minerare, sipas përcaktimeve të mësipërme.

Neni 6

Të drejtat dhe detyrimet e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

- Ministria garanton se ajo ka kompetenca dhe autoritet ligjor të plotë për të firmosur këtë Marrëveshje;
- Ministria garanton përdorim të pacenuar dhe të papenguar të sipërfaqeve të tokës, objekt i kësaj Marrëveshjeje, për periudhën e vlefshmërisë së kësaj Marrëveshjeje;
- Ministria garanton që sipërfaqet e karrierave do të jenë të lira nga pretendime të palëve të treta për ndonjë peng, pengese apo barrë të çfarëdolloji;
- Ministria merr përsipër që të ndihmojë Zotëruesin e lejes minerare për marrjen në rrugë ligjore të të gjitha lejeve dhe licencave për ndërtimin dhe vënien në funksionim të fabrikës për prodhimin e çimentos dhe të lidhjes rrugore të saj me karrierat dhe tregun, nga autoritetet shtetërore apo institucione të tjera nën kontrollin e tyre të drejtpërdrejtë dhe të ndihmojë që këto leje të jepen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 7

Kohëzgjatja e shfrytëzimit minerar

Ministria i garanton Zotëruesit të lejes minerare të drejtën e shfrytëzimit të mineraleve në zonën minerare për një kohëzgjatje prej 99 vitesh. Kjo periudhë kohore do të fillojë nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje pas nënshkrimit të saj, aprovimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe botimit në Fletoren Zyrtare.

Neni 8

Programi i punimeve

Zotëruesi i lejes minerare garanton se do të kryejë investimet e parashikuara në planin e ndërtimit dhe të shfrytëzimit, me qëllim realizimin e objektit të kësaj Marrëveshjeje. Projekti do të zbatohet sipas nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje dhe sipas planit përkatës të investimit të paraqitur. (Aneksi 2)

Neni 9

Përfundimi i Marrëveshjes së shfrytëzimit minerar

Ministria mund ta zgjidhë këtë Marrëveshje kur ajo gjykon se kanë ndodhur shkelje të vazhdueshme të detyrimeve të ndërmarra nga Zotëruesi i lejes minerare, të tilla që mund të bëjnë të pamundur vijimin e punimeve sipas parashikimit në planin e shfrytëzimit minerar.

Kur vihen re shkelje që mund të çojnë në pamundësi të vijimit të punimeve, Ministria duhet të njoftojë Zotëruesin e lejes minerare rreth këtyre shkeljeve dhe të presë 30 ditë për një përgjigje shpjeguese.

Mosplotësimi i ndonjërit nga detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje nuk duhet të konsiderohet që është një shkelje e kësaj Marrëveshjeje përsa kohë që kjo mospërmbushje vjen si pasojë e një ngjarjeje që konsiderohet si forcë madhore, dhe kur është provuar se Pala e prekur nga kjo ngjarje a) ka marrë të gjitha masat parandaluese të arsyeshme, si dhe të gjitha hapat e nevojshme për të zbatuar termat dhe konditat e kësaj Marrëveshjeje; dhe b) ka informuar menjëherë Palën tjetër për ndodhinë e kësaj ngjarjeje.

"Një ngjarje forcë madhore" do të thotë çdo ngjarje ose rrethanë apo kombinim i tyre që pengon plotësisht apo pjesërisht secilën nga Palët për plotësimin e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje, vetëm nëse dhe në atë masë që një ngjarje apo rrethanë e tillë është përtej kontrollit të arsyeshëm direkt apo indirekt të Palës së prekur nuk është shkaktuar nga një shkelje apo paaftësi e saj, dhe nuk mund të ishte parandaluar nga çfarëdo masë e arsyeshme që kjo Palë mund të kishte ndërmarrë.

Ngjarja forcë madhore përfshin ngjarjet në vijim, por nuk kufizohet me to, me konditën që ato të plotësojnë termat e sipërpërmendura:

i) Çdo akt lufte (i deklaruar apo jo), luftë civile, pushtim, konflikt i armatosur apo veprim i armikut të jashtëm, kryengritje apo terrorizëm, që përfshijnë apo ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në Republikën e Shqipërisë;

ii) Revolucion, protesta, rebelim ose çdo lloj revolte civile, akte terrorizmi apo sabotazhi, të cilat në çdo rast përfshijnë apo ndikojnë direkt Republikën e Shqipërisë;

iii) Greva të shpërndara gjerësisht dhe/ose në shkallë, politike, kombëtare;

iv) Kontaminim bërthamor, kimik ose biologjik, të cilat direkt apo indirekt ndikojnë sipërfaqen objekt të kësaj Marrëveshjeje, përveç rasteve kur shkaku i këtij kontaminimi vjen si rezultat i veprimeve të shoqërisë ose kontraktorëve të saj;

v) Epidemitë ose infeksionet, të cilat direkt ose indirekt ndikojnë në zonën e lejes minerare dhe ushtrimit të aktivitetit të prodhimit të çimentos.

Në raste vonesash të shkaktuara nga Ministria ose nga ndonjë organ tjetër shtetëror, i cili kryen funksionet e tij në lidhje të drejtpërdrejtë me lëshimin e licencave dhe lejeve të tjera ndërtimore të nevojshme për ndërtimin dhe vënien në funksionim të fabrikës për prodhimin e çimentos ose vonesa të pajustifikuara të shkaktuara nga organe të tjera qeveritare gjatë kryerjes së funksioneve që lidhen me këtë Marrëveshjeje dhe që nuk janë nën kontrollin e shoqërisë, periudha e vonesës nuk do të llogaritet në kuadrin e afateve kohore të vendosura më sipër.

Në rastet e forcës madhore, afatet kohore të përmendura në nenin 3 të mësipërm për Zotëruesin e lejes minerare do të shtyhen në përputhje me të, por në asnjë rast kjo nuk do të ndikojë në zgjatjen e periudhës së shfrytëzimit minerar, e cila mund të shtyhet vetëm sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Neni 10

Kontrolli dhe investimi

Ministria ka të drejtën dhe detyrimin që të kontrollojë rregullisht zbatimin e Marrëveshjes sipas kushteve të parashikuara në të dhe në përputhje me detyrimet e saj që rrjedhin nga "Ligji minerar i Shqipërisë" nr.7796, datë 17.2.1994.

Ministria dhe Zotëruesi i lejes minerare do të përcaktojnë së bashku mënyrën më të mirë të kontrollit, duke siguruar në të gjitha rastet që ky aktivitet nuk do të paraqesë ndërhyrje të paarsyeshme në zbatimin e projektit. Zotëruesi i lejes minerare do të japë çdo shpjegim teknik që kërkohet.

Zotëruesi i lejes minerare do të vërë në dispozicion të Ministrisë pasqyrat financiare vjetore të tij, të hartuara në përputhje me standardet e kontabilitetit, për qëllimine verifikimit të zbatimit të investimit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Në çdo rast kur Ministria identifikon shkelje, ajo do t'ia komunikojë me shkrim, në mënyrë mjaftueshmërisht të hollësishme, vërejtjet dhe gjetjet e saj Zotëruesit të lejes minerare, me kërkesën që punimet duhet të vazhdohen sipas objektit të kësaj Marrëveshjeje, vënë në dispozicion kohën e mjaftueshme për ndreqjen e tyre sipas rastit.

Neni 11
Ligji i aplikueshëm

Kjo Marrëveshje rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Ministria garanton se të drejtat e Zotëruesit të lejes minerare sipas kësaj Marrëveshjeje që lidhen me shfrytëzimin e karrierave për një periudhë prej 99 vitesh dhe përdorimi i tokës për një periudhë prej 99 vitesh do të zgjasin dhe do të vijojnë të qëndrojnë në fuqi, pavarësisht çdo ndryshimi të dispozitave ligjore që lidhen me to, të aplikueshme në Shqipëri që do të hyjnë në fuqi pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rastin e ndonjë mosmarrëveshjeje, e cila mund të ngrihet nga dhe në lidhje me këtë Marrëveshje gjatë zbatimit të saj, e cila nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim reciprok ndërmjet Palëve do të zgjidhet përfundimisht nëpërmjet arbitrazhit ndërkombëtar, në përputhje me rregullat e arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), nga një apo tre arbitra, që do të emërohen sipas rregullave të sipërpërmendura.

Vendi i arbitrazhit do të jetë në Paris, Francë dhe gjuha e arbitrazhit do të jetë anglishtja.

Neni 13
Bashkëpunimi

Ministria dhe Zotëruesi i lejes minerare bien dakord që të bashkëpunojnë me qëllimin për të garantuar zbatimin e projektit, siç është përcaktuar në këtë Marrëveshje.

Njoftimet dhe komunikimet e tjera ndërmjet Palëve duhet të dërgohen në adresat respektive të Palëve.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas firmosjes së saj nga Palët, dhe pasi ajo të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe më pas të miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr.7796, datë 17.2.1994, i ndryshuar.

NË EMËR TË MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Drejtor i Përgjithshëm
Kristo Rodi

NË EMËR TË SHOQËRISË "ANTEA CEMENT" SHA
Drejtor i Përgjithshëm
Eheftherios Gkaris

ANEKSI 1

Sipërfaqet (të shprehura në koordinata) e kërkuara nga Zotëruesi i lejes minerare për shfrytëzimin e mineraleve të grupit të katërt në zonën e Borizanës, siç përcaktohet në nenin 1 "Përkufizimi, zona minerare" të Marrëveshjes minerare të shfrytëzimit lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë "Antea Cement" sh.a.

1. Koordinatat që përcaktojnë sipërfaqen e karrierës së gëlqerorëve

Koordinatat e karrierës së gëlqerorëve		
Pika	**Y (lindje)**	**X (veri)**
QA	4.393.863.4820	4.602.687.9150

QB	4.393.896.8120	4.602.857.8360
QC	4.394.403.3310	4.603.137.7070
QD	4.394.716.5770	4.602.561.3050
QE	4.394.793.2290	4.602.411.3740
QF	4.395.073.1460	4.601.658.3910
QG	4.394.477.8470	4.601.449.6500
QN	4.394.560.2800	4.601.744.6410
QP	4.394.685.0580	4.601.769.4360
QR	4.394.908.6200	4.601.593.2770
QH	4.394.155.3110	4.602.104.8080
Sipërfaqja = 997557.00 m^2 (99.76 ha)		

2. Koordinatat që përcaktojnë sipërfaqen e karrierës flish-argjilave

Koordinatat e karrierës së flish-argjilave		
Pika	**Y (lindje)**	**X (veri)**
A	4.396.052.7710	4.602.602.6200
B	4.396.521.3780	4.603.117.9410
C	4.397.157.3440	4.602.638.3130
D	4.396.619.5620	4.602.053.8370
Sipërfaqja = 589441.997 m^2 (58.95 ha)		

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. **KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
2. **KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
3. **REGJISTRAT E NOTERISË**
4. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME**

BOTIME TË REJA

(Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE

Së shpejti në treg:

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat
- Kodi i familjes (përfshirë legjislacioni për birësimet)

Hyri në shtyp më 17.10.2007
Doli nga shtypi më 19.10.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
Tiranë, 2007

Çmimi 40 lekë